



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



Raporti i Auditimit të Performancës

Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media

Prishtinë, mars 2024

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetua dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit, që kryesohet nga Auditori i Përgjithshëm, e ndihmon në kryerjen e detyrave të tij/saj. Së bashku kontribuojnë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës "Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media", në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Labinot Sadiku, Udhëheqës i Ekipit

Alba Keqa Bejtullahu, Anëtare e Ekipit

Lindita Ajeti, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Lagja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +381(0) 38 60 60 04/1011

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike
² Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PERMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	1
Hyrje	3
Objektiva dhe pyetjet e auditimit.....	4
1. Gjetjet e auditimit	6
3.1 Dobësitë në procesin e licencimit të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të mediave nga KPM.....	7
3.1.1 Mos përmbushja e kriterëve me rastin e licencimit të operatorëve të shpërndarjes për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale	8
3.2 Problemet në procesin e ripërtëritjes së licencave nga KPM për ofruesit e shërbimeve mediatike	9
3.2.1 Mosrespektimi i afateve të ripërtëritjeve	9
3.2.2 Mungesa e respektimit të dispozitave materiale.....	11
3.2.3 Mungesa e konsistencës në dhënien e rekomandimeve nga KPM për ripërtëritje të licencave të mediave	13
3.2.4 Vonesat e KPM-së në vendimmarrje për ripërtëritjen e licencave	14
3.3 Dështimet në pezullimin dhe revokimin e licencave nga KPM dhe borxhet e akumuluar nga OSH-të	15
3.4 Dobësitë në mbledhjen e borxheve të OSH-ve nga ana e KPM-së.....	21
3.5 Revokimet e Licencave të ofruesve të shërbimeve mediatike nga KPM.....	24
4. Konkluzionet.....	27
5. Rekomandimet.....	29
I. Shtojca I. Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	30
Motivi i Auditimit.....	30
Kriteret e Auditimit	31
Fushëveprimi i auditimit	35
Metodologjia e auditimit.....	35
II. Shtojca II. Rastet e borxheve të detajuara përfshirë natyrën e tyre dhe vlerat. .	36
III. Shtojca III. Letër konfirmimi dhe komentet e entitetit	39

Lista e shkurtesave

KPM	Komisioni i Pavarur për Media
OSH	Ofrues i Shërbimeve
OSHP	Ofrues i Shërbimeve Programore
LLA	Llogari të arkëtueshme
OSHMA	Ofrues i Shërbimit Medial Audio
SHMAV	Shërbimi Medial Audio Vizual
OSHM	Ofrues i Shërbimit Medial
DL	Departamenti i Licencimit

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media”. Përgjegjës për sistemin e rregullimit të aktiviteteve të mediave në vend është Komisioni i Pavarur për Media. Objektivë e këtij auditimi ishte të vlerësojmë proceset dhe procedurat e Komisionit të Pavarur për Media në lidhje me licencimin e mediave, mbledhjen e tarifave të licencës dhe gjobave nga mediat. Po ashtu, të identifikohen arsyet e vështirësive me të cilat ballafaqohet Komisioni i Pavarur i Mediave në ripërtëritjen e licencave të mediave dhe mbledhjen e fondeve, veçanërisht për shkak të mospërbushjes së detyrimeve financiare.

Subjekt i këtij auditimi ishte Komisioni i Pavarur për Media me departamentet përgjegjëse dhe ka përfshirë periudhën 2008 deri në vitin 2022.

Procesi i menaxhimit të licencave të Ofruesve të Shërbimeve nga Komisioni i Pavarur për Media është karakterizuar me dobësi duke ndikuar që kriteret për aktivitetet mediatike të mos zbatohen. Mediat veprojnë pa përmbushur obligimet financiare të tarifave vjetore përgjatë viteve dhe pezullimet e licencave të mediave nuk realizohen nga Komisioni i Pavarur i Mediave ku për pasojë kemi grumbullim të borxheve. Në grumbullimin e borxheve ka ndikuar edhe mungesa e monitorimit të mediave me kohë dhe në mënyrën e duhur dhe ndërmarrja e hapave konkret ndaj atyre mediave të cilat nuk zbatojnë kriteret dhe anashkalojnë pagesat e tarifave vjetore. Po ashtu, ka vonesa të theksuara në mbledhjen e borxheve dhe probleme në kontrollet e brendshme të Autoritetit të mediave.

Operatorët e shpërndarjes dhe ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të mediave janë licencuar pa plotësuar kriteret. Komisioni i Pavarur i Mediave me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për licencat e transmetimit nuk ka marrë parasysh të gjitha kriteret sipas rregullores së përcaktuar. Nga gjithsej 21 mostra që janë analizuar për ofruesit e shërbimeve, në dhjetë raste është vërejtur se nuk janë përmbushur kriteret me rregulloret përkatëse duke mos përmbushur kriterin sikurse është vërtetimi tatimor dhe në një rast mungon diploma universitare. Nga dhjetë mostra që janë analizuar për operatorë të shpërndarjes, prej tyre në gjashtë raste nuk janë përmbushur të gjitha kriteret ashtu siç ishte paraparë me rregulloret përkatëse, ku mungojnë marrëveshjet valide për të drejtën e transmetimit për disa kanale të caktuara si të obligueshme për transmetim.

Ripërtëritja e licencave për mediat përcillet me mangësi të konsiderueshme të cilat rrezikojnë integritetin e sistemit të licencimit në Kosovë. Mediat nuk kanë respektuar në mënyrë të vazhdueshme afatin 60-ditor të aplikimit për ripërtëritjen e licencave dhe pavarësisht shkeljeve financiare, autoritetet rregullatore nuk kanë marrë masa ndëshkuese. Ka mungesë konsistente në rekomandimet për zgjatjen ose heqjen e licencës, duke çuar në interpretime subjektive. Në procesin e vendimmarrjes për ripërtëritje të licencave kishte vonesa të mëdha, kryesisht për shkak të mungesës së kuorumit në Komisionin e Pavarur të Mediave

duke ndikuar negativisht tek operatorët dhe shërbimet e transmetimit. Këto problematika ndikojnë në procesin e ripërtëritjes së licencave dhe integritetin e sistemit të licencimit në Kosovë.

Mbledhja e borxheve nga mediat dhe pezullimet-revokimet e licencave të tyre nuk janë realizuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga Komisioni i Pavarur për Media. Ky proces karakterizohet me dobësi në mbledhjen e borxheve të ofruesve të shërbimeve mediatike nga Komisioni i Pavarur për Media, përfshirë probleme me reagimin e vonuar të Komisionit të Pavarur për Media, mos respektim të procedurave ligjore dhe dobësitë në kontrollin brendshëm. Autoriteti rregullativ ka hasur sfida në pezullimin e licencave të ofruesve të shërbimeve mediatike pasi që proceset e pezullimit të licencave nuk janë ndjekur me kujdes. Po ashtu mungesa e monitorimit më proaktiv nga autoriteti rregullativ në zbatimin e detyrimeve financiare të ofruesve të shërbimeve mediatike dhe statusin e transmetimeve të tyre kanë shkaktuar akumulimin e borxheve. Për më tepër autoriteti rregullativ nuk kishte ndërtuar një mekanizëm të qartë për pezullimin e përkohshëm të licencave, duke kontribuar në sfida financiare për autoritetin rregullativ dhe ofruesit e shërbimeve mediatike.

Gjetjet e auditimit tregojnë se çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e licencave nga Komisioni i Pavarur i Mediave kërkojnë përmirësim të menjëhershëm dhe për këtë janë dhënë 5 rekomandime. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Komisioni i Pavarur për Media janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna me përjashtim të disa gjetjeve, komentet për të cilat i gjeni në shtojcën III.

Hyrje

Mediat, si burim kryesor i informacionit, kanë një rol shumë të rëndësishëm në shoqërinë tonë duke ndikuar në opinionin publik dhe në zhvillimin e kulturës dhe identitetit. Në Kosovë, mediat janë bërë një pjesë e rëndësishme e kulturës dhe komunikimit të përditshëm të njerëzve, dhe kanë një ndikim të rëndësishëm në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Institucioni përgjegjës në vendin tonë për licencimin e mediave është Komisioni i Pavarur i Mediave (tutje KPM) i cili siguron se të gjitha kompanitë që ofrojnë shërbime mediatike janë të pajisura me licencat e nevojshme dhe këto licenca janë në përputhje me kriteret ligjore⁶. Licencimi siguron se mediat janë të cilësisë së duhur dhe përmbushin kërkesat e parashikuara në legjislacionin përkatës dhe kriteret të cilat KPM-ja mund t'i përcaktojë sipas një procedure të drejtë dhe të hapur të konkurrencës.⁷

KPM siguron se mediat ofrojnë lajme të sakta dhe të rëndësishme për publikun. Për më tepër, licencimi ndihmon në rritjen e konkurrencës së ndershme dhe parandalimin e monopolizimit të fushës së mediave.

KPM duhet të ndjek veprime ligjore nëse mediat nuk paguajnë tarifatat e tyre të licencimit. Kjo mund të përfshijë një ndalim të aktiviteteve të medias dhe pagesa e detyrimeve të papaguara për të mbrojtur interesat e autorëve.

Në vazhdim janë paraqitur vlerat e tarifave vjetore të mediave përfshirë këtu operatorët programor, operatorët e shpërndarjes dhe ofruesit e shërbimeve.

⁶ Ligji Nr.04 L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, neni 3, neni 5 paragrafi 3.

⁷ Ligji Nr.04 L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, neni 22, paragrafi 2.

Tabela 1. Niveli i taksës vjetore të licencës për subjektet transmetuese tokësore nga viti 2010.⁸

Lloji i subjekteve transmetuese tokësore	A ⁹	B ¹⁰	C ¹¹	D ¹²	Shuma vjetore në euro
Radio me fuqi të ultë	20	1	1	1	240
TV me fuqi të ultë	20	1	1.5	1	360
Radio lokale	20	1.5	1	1.5	540
TV lokale	20	1.5	1.5	1.5	810
Radio regjionale	20	3	1	1.75	1,260
TV regjionale	20	3	1.5	1.75	1,890
Radio Nacionale	20	21	1	2	10,080
TV Nacionale	20	21	1.5	2	15,120

Nga vlerësimet preliminare është vërejtur se deri në vitin 2022 që nga viti 2009 (kur edhe ka filluar licencimi i mediave) mediat ndaj KPM-së kanë obligime për tarifa për licencë dhe gjoba të cilat e kanë statusin e të arkëtueshmeve të cilat nuk janë paguar nga Ofruesit e Shërbimeve Mediatike (tutje OSHM) ndaj KPM-së. Këto janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave.

Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivi i auditimit është të vlerësojmë proceset dhe procedurat e KPM-së në lidhje me licencimin e mediave, monitorimin e tyre dhe mbledhjen e tarifave të licencës dhe gjobat nga mediat. Po ashtu, të identifikohen arsyet e vështirësive me të cilat ballafaqohet KPM-ja në ripërtëritjen e licencave të mediave dhe mbledhjen e fondeve, veçanërisht për shkak të mospërbushjes së detyrimeve financiare.

⁸ Rregullore KPM.

⁹ Vlera bazë e shprehur (A) - e llogaritur në bazë të buxhetit të përgjithshëm vjetor e pjestuar me numrin e subjekteve të licencuara transmetuese tokësore, numrin e ditëve të vitit dhe me 24 orë.

¹⁰ Mesataren e numrit të banorëve të mbetur (B).

¹¹ Llojit të subjektit transmetues tokësor (C) - radio dhe TV dhe;

¹² Kategorisë së subjektit transmetues tkësor (D).

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit kemi parashtruar pyetjen e auditimit si në vijim:

A ka siguruar KPM se janë zbatuar proceset dhe procedurat e licencimit dhe ri licencimit në mënyrën e duhur dhe a janë ndërmarrë hapa konkret ndaj ofruesve të shërbimeve mediale dhe audio vizuale të cilët nuk kanë paguar tarifat dhe kanë vepruar në kundërshtim me kriteret dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve?

Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi ka qenë Komisioni i Pavarur për Media duke u fokusuar në: Departamentin për Licencim, Departamentin e Monitorimit dhe Analizës së Mediave (DMA) dhe Departamentin Ligjor dhe atë të Financave. Fushëveprimi ka mbuluar periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2022.

Metodologjia dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.

1. Gjetjet e auditimit

KPM si autoritet kryesor për funksionimin e mediave ka për qëllim rregullimin dhe menaxhimin e spektrit të frekuencave transmetuese dhe mbledhjen e taksave për përdorimin e këtyre frekuencave transmetuese. KPM është përgjegjëse për licencimin e transmetuesve publik dhe privat dhe për sigurimin e përputhshmërisë me standardet Evropiane.

Departamenti i Licencimit (DL) në kuadër të KPM-së bënë shqyrtimin dhe procedimin e kërkesave për licenca të reja nga ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale dhe operatorëve të shpërndarjes. Për të aplikuar për një licencë mediale, kompanitë plotësojnë disa kriteret të caktuara, duke përfshirë një plan biznesi të detajuar, një plan programesh dhe të kenë një staf profesional dhe të trajnuar.¹³ Mediat kanë detyrimin të kërkojnë ripërtëritjen e licencave 60 ditë para skadimit të tyre. Gjatë procesit të ripërtëritjes, KPM vlerëson nëse mediat janë në përputhje me kriteret dhe po respektojnë pagesën e taksave dhe gjobave. Në rast se mediat nuk plotësojnë obligimet e tyre, KPM ka kompetencën për të pezulluar ose revokuar licencat e tyre.

Obligimet për tarifën vjetore për licencë për periudhën 2011-2013 janë proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore ndërsa për vitet 2014-2022 janë proceduar te përmbaruesi privat.

Departamenti Ligjor i KPM-së gjatë vitit 2022 ka dërguar në përmbarim 50 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (tutje OSHMA) të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2022. Po ashtu, në përmbarim janë dërguar edhe dhjetë raste për mos pagesë të gjobave të shqiptuara nga Komisioni i KPM-së.¹⁴

Gjetjet e auditimit tregojnë për një proces kompleks të funksionimit të mediave elektronike dhe rregullimit të aktiviteteve të tyre. Këto ngecje lidhen direkt me lëshimet e autoritetit rregullator të mediave KPM në njërën anë dhe në anën tjetër neglizhencat dhe mos respektimi i kriterëve dhe rregullave nga ana e mediave.

KPM për një periudhë të gjatë ka lejuar që të grumbullohen borxhe lidhur me mos pagimin e tarifës vjetore dhe gjobave nga ana e mediave duke qenë shumë e rezervuar në shfrytëzimin e mekanizmave ligjor dhe marrjen e vendimeve për të mbajtur mediat në përgjegjësi. Po ashtu, procesi i licencimit të mediave, ripërtëritjes dhe monitorimit të tyre është karakterizuar me mangësi.

Më poshtë janë paraqitur gjetjet të cilat janë rezultat i analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, auditimit të proceseve, testeve si dhe intervistave me zyrtarë përgjegjës në terren. Në përputhje me standardet profesionale, në raport nuk janë përmend

¹³ KPM 2013/04 Rregullorja e KPM-së për dhënien e licencës.

¹⁴ Raprti vjetor i punës KPM 2022, fq 49.


ofruesit e shërbimeve me emrat e tyre, por ju kemi referuar si OSH dhe me numër rendor. Dëshmitë e mbledhura kanë shërbyer në dhënien e konkluzioneve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 4 dhe rekomandimeve për përmirësimin e proceseve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 5.

3.1 Dobësitë në procesin e licencimit të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale të mediave nga KPM

Ofruesit e shërbimit mediale audio dhe audiovizuel mund të parashtrojnë kërkesë pa konkurs në çdo kohë tek KPM ndërsa me transmetim tokësor bëhet përmes procedurës së konkursit publik¹⁵. KPM-ja me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për licencat e transmetimit, merr parasysh kriteret si: kapacitetin për zhvillimin e programit vetanak; prejardhjen dhe shkallën e burimeve financiare të aplikantit; realizueshmërinë financiare të propozimit të aplikantit; kapacitetin teknik të aplikantit për të ofruar transmetim cilësor, nevojën për të siguruar program të shumëllojshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. KPM duhet të lëshoj vendimet mbi refuzimin ose mos ripërtëritjen e licencës për ofruesin e shërbimit medio audio vizuele dhe duhet të jenë të arsyetuara me shkrim dhe ato u dorëzohen aplikantëve nëpërmjet Zyrës Ekzekutive¹⁶.

Procesi i lëshimit të licencave kishte filluar nga viti 2009 ku deri në vitin 2022 janë dhënë një numër i konsiderueshëm i licencave për operatorët e shpërndarjes, për shërbimet audio vizuale dhe për licencat e Ofruesve të Shërbimeve Programore (tutje OSHP) nga KPM. Në grafet 1 dhe 2 janë paraqitur 36 licencat për OSHP-të, 110 licenca për shërbimet audio vizuale (tutje SHMAV) dhe 35 licenca për operatorët e shpërndarjes (tutje OSH) përgjatë këtyre viteve.


Grafikoni 1. Licencat e Ofruesve të Shërbimeve programore dhe licenca të lëshuara për shërbime mediale Audio Vizuale përgjatë viteve 2009 - 2019/22.



¹⁵ Rregulore për Ofruesit e Shërbimit Medial Audio dhe Audiovizuale 2021, neni 8 dhe 11.

¹⁶ Raporti vjetor i punës për vitin 2021 nga KPM, fq 56.

Grafikoni 2. Licencat e Operatorëve të Shpërndarjes përgjatë viteve 2009 – 2022.



Nga gjithsej 21 mostra të analizuar dhe testuar për procedurën e licencimit për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, në dhjetë raste është vërejtur se nuk janë përmbushur kriteret me rregulloret përkatëse, nga të cilat në nëntë raste nuk është përmbushur kriteri raporti me taksat¹⁷, sikurse është vërtetimi tatimor dhe në një rast nuk është përmbushur kriteri për diplomën universitare¹⁸. Kjo kishte ndodhur për shkak se kriteret e lartë përmendura nuk konsideroheshin mjaftë të rëndësishme nga zyrtarët e KPM-së. Arsyetimi i zyrtarëve të KPM-së ishte se diplomat e shkollës së mesme profesionale janë konsideruar, ekuivalente me diplomat universitare. Kriteret e lartë përmendura nuk konsideroheshin mjaftë të rëndësishme nga zyrtarët e KPM-së.

Mos përmbushja e kriterëve me rastin e licencimit përveç që nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin dhe rregulloret e brendshme të KPM-së, me rastin e mungesave të vërtetimeve tatimore KPM rrezikon që të licencojë media që kanë obligime tatimore dhe si rrjedhojë edhe probleme financiare. Po ashtu në anën tjetër, angazhimi i personave të pa kualifikuar sikurse kërkohet me diplomë universitare, rrezikon veprimtarinë profesionale të mediave.

3.1.1 Mos përmbushja e kriterëve me rastin e licencimit të operatorëve të shpërndarjes për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale

Me qëllim të sigurimit të qasjes së publikut në ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale, që ofrojnë përmbajtje programore në interes të përgjithshëm të tyre, dhe në mënyrë që të promovohet dhe sigurohet pluralitet medial, të licencuarit i nënshtrohen detyrimit për bartje të obligueshme¹⁹.

¹⁷Rregullorja CIMC 2009/02 kualifikimet për licencë, C.Raporti me Taksat.

¹⁸ Rregullorja 2017/02.

¹⁹ Rregulloren e brendshme KPM-2016/01, neni 9. Pika 1.

Për licencim të operatorëve të shpërndarjes për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale kërkohen dëshmitë mbi gatishmerinë për sigurimin e marrëveshjeve valide për të drejtën e transmetimit, për të gjitha kanalet komerciale që do të jenë pjesë përbërëse e katalogut dhe ofrimin e katalogut të kanaleve, të nënshkruar nga kandidati, mbi bazën e së cilës do të lëshohet licenca e KPM-së²⁰.

Nga totali i 38 licencave të lëshuara nga KPM për Operatorë të Shpërndarjes, janë testuar dhjetë mostra për procedurën e licencimeve. Nga këto dhjetë mostra në gjashtë raste nuk janë përmbushur të gjitha kriteret ashtu siç ishte paraparë me rregulloret përkatëse.

Nga 10 mostrat e testuara në gjashtë raste mungojnë marrëveshjet valide për të drejtën e transmetimit (për disa kanale të caktuara si të obligueshme/bazike për transmetim sikurse janë OSH 12, OSH 21 etj). Në tre nga këto gjashtë raste, mungojnë nga katër marrëveshje të tilla.

Në dy raste, dy kanale nga lista e obligueshme (OSH 12, OSH 21 etj) nuk ishin prezantuar fare në listën e kanaleve, gjithashtu mungonin edhe kontratat dhe në një rast nuk kishte asnjë kontratë me OSHM-të.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e KPM-së kishin konsideruar si të mjaftueshme vetëm rregulloret e dërguara tek operatorët e shpërndarjes, duke mos i dhënë rëndësi kërkesave me rastin e licencimeve.

Mos përmbushja e kriterëve me rastin e licencimit përveç që nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin dhe rregulloret e brendshme të KPM-së, ndikon në mos promovimin dhe mos sigurimin e pluralitetit medial.

3.2 Problemet në procesin e ripërtëritjes së licencave nga KPM për ofruesit e shërbimeve mediatike

Në këtë kapitull janë përfshirë gjetjet që kanë të bëjnë me procesin dhe respektimin e afateve të ripërtëritjeve, respektimi i dispozitave materiale, dhënia e rekomandimeve nga KPM-ja për ripërtëritje të licencave të mediave dhe vendimmarrjet për ripërtëritjen e licencave.

3.2.1 Mosrespektimi i afateve të ripërtëritjeve

Mediat bëjnë kërkesën për ripërtëritje të licencave në afat prej 60 ditëve para skadimit të licencës. Ky proces bëhet përmes një kërkesë dhe përmes pagesës së taskës prej 100 euro²¹. KPM-ja, brenda tridhjetë

²⁰ KPM-2016/01 (shtojca), neni 3, pika.6&7.

²¹ Rregullore për tarifen vjetore të licencës 2017/06, Neni 2. **9**

(30) ditësh pas përfundimit të datës për aplikim, vendos mbi bazat e konkurrencimit se a do t'ia lëshojë licencën ose ripërtëritjen një aplikanti²².

Baza ligjore për ripërtëritje të licencave përcakton se ripërtëritja për licencë bëhet vetëm me anë të një kërkesë nga ana e operatoreve dhe nuk mund të ripërtërihet në rast të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit²³.

Përgjatë viteve gjithsej janë lëshuar 37 licenca OSHMA dhe OSH ku nga këto licenca janë analizuar dhe vlerësuar 21 licenca.

Fillimisht, është analizuar nëse kërkesa për ripërtëritje është dorëzuar brenda afatit kohor (60 ditë para skadimit të licencimit)²⁴. Po ashtu, është evidentuar nëse ka shkelje të dispozitave materiale në lidhje me kriteret e licencimit, duke përfshirë dëshminë e pagesës së tarifës vjetore të taksës 100 euro që është përfshirë në kërkesën e dorëzuar për ripërtëritje. Po ashtu është analizuar edhe dokument/rekomandimi i Komisionit i cili vendos për ripërtëritjen apo jo të licencës.

Kemi vlerësuar se një numër i konsiderueshëm i OSH-ve nuk ka arritur të përmbushin afatin prej të paktën 60 ditësh para skadimit. Nga 15 OSH, gjashtë prej tyre²⁵ nuk kanë dorëzuar kërkesat e tyre për ripërtëritje brenda afatit. Edhe përkundër kësaj, KPM nuk ka ndërmarrë masa disiplinore apo nuk ka aplikuar vërejtje ndaj operatorëve.

Ndërsa KPM kujdeset që ti rikujtojë të licencuarit për mundësin dhe afatin për dorëzimin e kërkesës për ripërtëritje, nuk është ligjrisht e detyruar ta bëjë këtë. Edhe pse në ndërkohë të licencuarit kanë dorëzuar kërkesat e tyre së bashku me arsyetimet me shkrim për vonesa, praktika e KPM-së është që të mos vendos masa disiplinore për ripërtëritje të vonuara, e që mund të ketë përcjellë një ndjenjë mirëkuptimi tek OSH-të.

Gjetja e identifikuar në lidhje me mosparaqitjen në kohë të kërkesave për ripërtëritje të licencave nga ana e OSH-ve, shoqëruar me mungesën e masave zbatuese nga KPM-ja, ka disa pasoja. Së pari, ekziston rreziku i ndërprerjes së shërbimeve të transmetimit nga OSH-ja ndaj klientëve, pasi kërkesa me vonesë rrit mundësinë e ndërprerjeve dhe pezullimeve të përkohshme nga KPM-ja. Së dyti, koha përgjatë së cilës OSH llogaritet pa licencë pasi që ka bërë kërkesë me vonesë, rrezikon që OSH-të në ndërkohë mund të bëjnë shkelje të kriterëve dhe si pasojë nuk do të ketë bazë ligjore për ndëshkime dhe të tjera. Kjo rrezikon që KPM mos ta ketë nën mbikëqyrje OSH-në i cili vepron me licencë të skaduar. Praktika e KPM-së që të mos vendos masa disiplinore për kërkesa të vonuara për ripërtëritje, mund të rezultojë që OSH-të të mos e vlerësojnë plotësisht nevojën e respektimit rigoroz të afatit kohor të ripërtëritjes.

²² Ligji për KPM Neni 23 pika 3.

²³ Ligji për KPM Neni 22.

²⁴ Ligji për KPM Neni 5

²⁵ (OSH 1, OSH 2, OSH 3, OSH 4, OSH 5 dhe OSH 6).

3.2.2 Mungesa e respektimit të dispozitave materiale

KPM është përgjegjëse për monitorimin e përmbushjes së obligimeve të operatorëve të licencuar dhe në rastet kur operatorët nuk përmbushin përgjegjësitë e tyre financiare dhe të tjera KPM duhet ti shqyrtoj këto raste. Me rastin e dorëzimit të kërkesës për vazhdim të licences për OSHMA dhe OSH operatorët duhet të paguajnë tarifa administrative²⁶, tarifat vjetore dhe gjokat e papaguara (dispozitat materiale) të grumbulluara përgjatë viteve²⁷.

Janë identifikuar shkelje të dispozitave materiale nga OSH-të gjatë procesit të ripërtitjes së licencës. Nga analiza e të dhënave rezulton se pesë 5²⁸ OSH-të nga 15 prej tyre kishin tarifa vjetore për licenca dhe gjoka të papaguara në momentin e kërkesave për ripërtitje të licencës. Për më tepër, në disa raste, këto tarifa dhe gjoka të papaguara ishin grumbulluar gjatë disa viteve. OSH 8 kishte tarifa vjetore të papaguara për licencën që arrinin në 3,390 euro që nga viti 2015 dhe OSH 9 kishte tarifa të papaguara në total prej 5,280 euro që nga i njëjti vit e deri në vitin 2022. Gjithashtu, vetëm në vitin 2021, OSH 10 kishte katër vendime gjokë për shkelje të kritereve, në shumën totale prej 14,374.20 euro.

Për këtë KPM kishte proceduar përmes përmbaruesit privat mbledhjen e detyrimeve financiare. Përmbaruesi privat mori përgjegjësinë për mbulimin e llogarive dhe mbledhjen e borxheve të lëna nga OSH-të për KPM-në. Pavarësisht autoritetit të dhënë me ligj, ku lejon KPM-në të lëshojë vërejtje me shkrim ose t'u shqiptojë gjokë për shkelje të kushteve të licencës, në asnjë prej këtyre rasteve nuk është ndërmarrë asnjë veprim i tillë.

Në procesin e ripërtitjes së licencës katër OSH-të nuk kanë sjellur dëshminë mbi pagesën e taksës vjetore administrative prej 100 euro ndërsa ka vazhduar procesi i ripërtitjes nga ana e KPM-së. Megjithatë, në përmes departamentit të financave në KPM kemi siguruar këto dëshmi të cilat tregojnë se është realizuar pagesa²⁹.

Mangësia në sigurim dhe vërtetim të pagesave ndikon drejtpërdrejt në saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ripërtitjes dhe kjo mund të çojë në vonesa në përpunimin e kërkesave për ripërtitje, pasi mungesa e dëshmive të nevojshme të pagesës kërkon hapa shtesë të verifikimit.

Shkaku i vendimit të KPM-së për të mos lëshuar gjoka gjatë procesit të ripërtitjeve të licencës për shkelje të dispozitave materiale që lidhen me tarifat vjetore të papaguara dhe gjokat të tjera për shkelje të rregullave gjatë transmetimit, mund t'i atribuohen një sërë probleme në vazhdim sikurse:

²⁶ Rregullore për tarifen vjetore të licences 2017/06, Neni 2 dhe Neni 14

²⁷ Ligji Nr.04 L-44 për KPM, Neni 25

²⁸ (OSH 1, OSH 7, OSH 8, OSH 9, dhe OSH 10)

²⁹ (OSH 9, OSH 5, OSH 10 dhe OSH 25).

- Sipas KPM-së shqiptimi i gjobave për shkelje të kushteve të licencës (mos pagesë të tarifës vjetore) vetëm se e përkeqëson barrën financiare mbi të licencuarit.
- Sipas KPM-së ndëshkimi me kamata për gjobat e mos paguara po ashtu ngarkon të licencuarin financiarisht ndërsa qëllimi i KPM-së është të inkurajojë pajtueshmërinë dhe shlyerjen e tarifave në vend të vendosjes së gjobave ndëshkuese që mund të rëndojnë më tej situatën financiare të të licencuarve.

Vendimi i KPM-së për të lejuar ripërtëritjen e licencës edhe me detyrime financiare të papaguara, së bashku me udhëzimet për të licencuarit që të shlyejnë borxhet e tyre ose të përballen me procedura ligjore me ekzekutuesit privat, nga KPM shihet si një ekuilibër midis zbatimit të përputhshmërisë dhe lejimit të një shansi të të licencuarve për të korrigjuar situatën e tyre financiare pa ndikuar para kohe në statusin e tyre të transmetimit. Sa i përket tarifës administrative 100 euro, palët kanë bërë pagesën, por nuk kanë ofruar dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar kryerjen e kësaj pagese.

Në disa raste, dëshmia është dërguar përmes e-mail, por nuk është ruajtur në mënyrë të duhur ose nuk është disponuar në dosjen e tyre. Pagesat janë verifikuar në çdo rast përmes sistemit financiar që është i lidhur me realizimin e këtyre pagesave. Fillimisht, Divizioni i Financave në KPM ka konfirmuar se pagesa është kryer, dhe më pas, në bazë të verifikimit, është rekomanduar ose nuk është rekomanduar kërkesa ose lënda për trajtimin e mëtejshëm.

Mospërmbushja e kriterëve lidhur me kërkesën për ripërtëritjen e licencës nga OSH-të dhe moszbatimin e ligjit nga KPM-ja sjell disa pasoja:

- dëmton integritetin e procesit të licencimit,
- krijon avantazhe të padrejta ndërmjet OSH-ve,
- dobëson autoritetin rregullator të KPM-së dhe
- akumulon tarifa dhe gjoba vjetore të pa paguara gjatë viteve siç vërehet në rastet e OSH 8 dhe OSH 9.

Kjo përveç që tregon mungesë të përgjegjësisë financiare nga OSH-të, po ashtu përbën një barrë financiare për KPM-në. Shfrytëzimi i mekanizmave sikurse janë gjykatat dhe përmbaruesi nxjerr në pah paaftësinë e KPM-së për të mbledhur në mënyrë efektive tarifën e papaguara dhe për të zbatuar llogaridhënien financiare. Kjo dobëson autoritetin rregullator të KPM-së dhe ngre shqetësime në lidhje me kapacitetin e saj për të zbatuar pajtueshmërinë me kërkesat e licencimit.

3.2.3 Mungesa e konsistencës në dhënien e rekomandimeve nga KPM për ripërtëritje të licencave të mediave

Vlerësimi dhe rekomandimi i kërkesave për ripërtëritje të licencave bëhet nga Komisioni i KPM-së. Procesi i vlerësimit të aplikacioneve për licencë të shërbimeve mediale audiovizuale dhe ripërtrirja e licencave duhet të jetë i drejtë dhe transparent. Vendimet e KPM-së mbi refuzimin ose mosripërtrirjen e licencës për ofruesin e shërbimit media audiovizuel duhet të jenë të arsyetuara me shkrim dhe ato u dorëzohen aplikantëve nëpërmjet Zyrës Ekzekutive³⁰.

Në mostrat e përzgjedhura nuk kemi hasur në ndonjë rast ku rekomandimi për ripërtëritje ka munguar. Megjithatë, komisioni i KPM-së kishte dhënë arsyetime të ndryshme dhe ndonjëherë të pamjaftueshme për rekomandimet për ripërtëritje të licencës. Në rastet kur OSH-të ishin në përputhje, arsyet pasqyronin me saktësi respektimin e tyre ndaj provizioneve materiale dhe detyrimeve financiare³¹. Megjithatë, në rastet e mospërputhjes apo përmbushjes së parregullt financiar, arsyetimet kanë munguar dhe nuk kanë dhënë një vlerësim të drejtë dhe të saktë.

Këto paraqesin ndryshime dhe jo konsistencë në rekomandimet e vendimeve të KPM-së për OSH-të në ripërtëritjen e licencave. KPM-ja është mbështetur në interpretimin e vendimit³², i cili lejon ripërtëritjen e licencës edhe në rastet e detyrimeve financiare të papaguara dhe me të njëjtin i ka udhëzuar që ti shlyejnë obligimet, në të kundërtën ato do të realizohen përmes procedurave ligjore të Përmbaruesit Privat³³. Megjithatë, KPM nuk ka dhënë një arsyetim konkret sa i përket justifikimeve të ndryshme në rekomandime bazuar në faktin nëse kandidati ka përmbushur detyrimet e tij financiare ose ka pasur shkelje që mund të pengojnë ripërtëritjen.

Kjo mos përputhje në dhënien e rekomandimeve në vendime zbeh transparencën dhe drejtësinë e procesit të ripërtëritjes. Kjo praktik në disa raste dhënien e rekomandimeve ndërsa në disa raste jo, zvogëlon integritetin e procesit të vendimmarrjes.

Po ashtu, mungesa e vendimeve të standardizuara në rastet e shkeljeve apo parregullsive financiare ngre shqetësime për trajtimin e barabartë mes operatorëve mediatik. Kjo mund të shpie në raste kur operatorët që përballen me shkelje të ngjashme ose çështje financiare marrin trajtim të ndryshëm bazuar në interpretimin subjektiv të vendimit. Për më tepër, mbështetja në kërkesën për ripërtëritje e cila është e vetmja bazë që kërkohet për ripërtëritje, duke mos i shqyrtuar detyrimet financiare që i kanë, mund të shpie në mbikëqyrje joadekuate të operatorëve mediatik dhe vazhdimin e transmetimit nga mediat të cilat kanë

³⁰ Ligji Nr. 04-L-44 per KPM Neni 24

³¹ OSH 2.

³³ KPM V3-2016 Vendim.

shkelje ose vështirësi financiare. Rrjedhimisht, këto pasoja mund të ndikojnë në llogaridhënien dhe besueshmërinë e procesit të licencimit dhe ripërtëritjes të licencave të mbikëqyrur nga KPM.

3.2.4 Vonesat e KPM-së në vendimmarrje për ripërtëritjen e licencave

Vonesa të konsiderueshme janë identifikuar edhe në procesin e vendimmarrjes për ripërtëritje të licencave. Sipas afatit kohor të përcaktuar, një vendim duhet të merret brenda 30 ditëve pas përfundimit të datës së aplikimit. Megjithatë, nga 15 mostrat e analizuar, tetë³⁴ prej tyre pësuan vonesa që ishin nga tre muaj deri në një vit. Po ashtu, dy³⁵ OSH-të të cilat janë publike nuk kanë marrë ende asnjë vendim që nga data 12.08.2022.

Shkaku i vonesave të konsiderueshme në procesin e vendimmarrjes për ripërtëritjen e licencave i atribuohet mungesës së kuorumit brenda KPM-së. Kjo mungesë e kuorumit, pengoi aftësinë e KPM-së për të marrë vendime gjatë kësaj periudhe. Rrjedhimisht, kërkesat për ripërtëritje të licencave që kërkonin vendimmarrje të KPM-së nuk ishin në gjendje të shqyrtoheshin dhe adresoheshin në kohën e duhur. Kjo vonesë u shtua më tej në rastet kur kërkesat për ripërtëritje ishin dorëzuar me vonesë, duke përkeqësuar vonesën e përgjithshme në rezultatet e vendimeve. Gjithashtu, shtyrja e rasteve, për dy OSH-të publike, për shkak të detyrimeve të papaguara financiare tregon se si çështjet administrative dhe financiare mund të kontribuojnë edhe në zvarritjen e procesit të vendimmarrjes.

Vonesat në vendime nga Komisioni i KPM që tejkalojnë afatin e caktuar prej 30 ditësh pengojnë funksionimin normal të shërbimeve të transmetimit dhe mund të prishin vazhdimësinë e operatorëve. Këto vonesa kanë ndikim dhe ulin efektivitetin e procesit të ripërtëritjes së licencave. Në rastet kur ka vonesa deri në një vit, parimisht tregon se këto OSH aktivitetet e tyre të transmetimit i mbajnë pa një licencë të aprovuar.

Këto vonesa në ripërtëritjen e licencave përfshijnë ndërprerjet e mundshme të shërbimeve të transmetimit, paaftësinë për të monitoruar dhe pamundësinë e rregullatorit për të sanksionuar në rast shkeljeje të rregullores apo kushteve të punës, duke zbehur integritetin e përgjithshëm të organit rregullator ku gjithashtu rrezikojnë transmetimin e programeve audio vizuale të ndaluara.

³⁴ OSH 2, OSH 3, OSH 4 OSH 11.

³⁵ OSH 8 dhe OSH 9.

3.3 Dështimet në pezullimin dhe revokimin e licencave nga KPM dhe borxhet e akumuluar nga OSH-të


Tarifa vjetore për licencë për të gjitha kategoritë e licencave të KPM-së do të depozitohen në llogarinë bankare të KPM-së deri më 30 Qershor të vitit respektiv³⁶. Në rastin e licencimit tarifa e parë për licencë do të paguhet jo më vonë se 14 ditë nga pranimi i vendimit për licencim ndërsa llogaritja e tarifës vjetore e licencës do të bëhet nga muaji në të cilin merret vendimi për licencim³⁷.

Subjektet e licencuara duhet të veprojnë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, të politikave transmetuese, në pajtueshmëri të plotë me të gjitha aktet nënligjore si dhe me kushtet dhe termat e licencës.³⁸ KPM duhet të mbledh taksat për shfrytëzim të frekuencave nga të gjitha OSHMA-të³⁹.

Mos pagesa e taksës së licencës ndaj KPM-së, do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues, ku mund të rezultojë edhe me revokim të licencës.⁴⁰

Detyrimet/borxhet e OSH-ve ndaj KPM-së, të cilat e kanë statusin e të arkëtueshmeve janë në vlerë prej 795,970 euro, të cilat nuk janë paguar përgjatë viteve 2009 - 2022⁴¹ si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave.

Grafikoni 4. Të arkëtueshmet nga gjoba, tarifa për licenca, nga të hyrat për licenca dhe faturat e lëshuara për vitin 2021 dhe 2022.



³⁶ Rregullore 2017/03 dhe 2017/06.

³⁷ paragrafi 1.6 neni 30 i Ligjit "t'ia ndërpresë apo refuzojë vazhdimin e licencës së transmetimit"

³⁸ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 Aplikimet për licencat e transmetimit. neni 21.

³⁹ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 Aplikimet për licencat e transmetimit. neni 3.

⁴⁰ Rregullore 2010, për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediale audio - vizuale neni 5 fq 4.

⁴¹ Raporti Vjetore i KPM për vitin 2022.

Nga grafikoni 4 shohim borxhet e akumuluar nga mos pagesa e tarifave vjetore për licencë dhe nga mos pagesa e gjobave për shkelje të kritereve nga OSH-të për vitin 2021 dhe 2022.

Për shkelje të kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së⁴², KPM-ja duhet t'u lëshojë të licencuarve vërejtje me shkrim ose t'u shqiptojë një apo më shumë prej këtyre sanksioneve: t'i vendosë një gjobë në vlerë jo më pak se njëmijë (1.000) euro dhe jo më shumë se njëqindmijë (100.000) euro⁴³.

Departamenti i licencimit në kuadër të KPM-së duhet të inicioj rastet për në gjykatë dhe të shfrytëzoj mekanizmat tjerë (sikurse janë përmbaruesit) për të mbledhur të hyrat nga taksat dhe gjobat nga OSH-të. Vendimet e Bordit për Ankesa janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me ligjin në fuqi.⁴⁴ Për vitet pasuese taksa do të paguhet jo më vonë se 20 ditë pas fillimit të vitit kalendarik.⁴⁵ Taksat vjetore për lëshimin e licencës për transmetimin e sinjaleve radio dhe televizive do të paguhet jo më vonë se data 5 e muajit aktual. Vonesat në pagimin e taksës po ashtu kanë ndëshkim me kamatë ndërsa mos pagimi i taksës do të rezultojë në sanksionimin e subjektit edhe me revokim të licencës⁴⁶. Mungesa e monitorimit të rregullt dhe vlerësimit të gjendjes së OSH-ve ka bërë që KPM të mos arrijë të vlerësoj me kohë dhe të merr parasysh kërkesat e OSH-ve për ndërprerjen dhe pezullimin e licencës ku për pasojë janë akumuluar borxhe. SHMAV-të duhet t'i paraqesin raport vjetor KPM-së, në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me ligj.⁴⁷

Kemi analizuar 61% apo 460,837 euro nga totali i borxhit 795,970 euro, ku janë evidentuar gjetjet të cilat kanë të bëjnë me mos pagesën e tarifave vjetore dhe mos pagesën e borxheve të gjobave përgjatë viteve 2009 - 2022.

Në tabelën 2 janë paraqitur borxhet e OSH-ve ndërsa informatat shtesë lidhur me natyrën e gjobave dhe taskave janë evidentuar në shtojcën II.

⁴² Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 29.

⁴³ Udhëzimet e KPM-së në Zbatimin e Sanksioneve të Licencuarve, fq 1 dhe 6. s

⁴⁴ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 44. **16**

⁴⁵ CIMC vendim për nivelin mënyren e pecaktimit të pageses së taskes për licencim të operatoreve kablore dhe ofruesve të shërbimeve programeve përmes kablos.

⁴⁶ Rregullore për taksa vitj 2007, fq5, neni 6 dhe Rregullore për taksa 2008 fq 5 dhe rregullore 2010 fq 4.

⁴⁷ Ligji nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 28

Tabela 2. Borxhet e OSH-ve ndaj KPM-së për taksat vjetore, gjobat dhe kamatat përgjatë viteve 2008 – 2022.⁴⁸

Ofruesi i shërbimit	Data e pajisjes me licencë	Borxhi total i akumuluar 2009 – 2022 në euro	Borxhi për taksës vjetore në euro	Borxhi nga gjobat në euro	Gjendja e tanishme e lëndës ndaj OSH
OSH 26	2008	13,000		13,000 euro. Shkeljen e kriterëve programore të rregullores për Komunikime Komeriale.	
OSH 13	2010	16,463		shkelje të licencës dhe shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.	Proceduar tek përmbaruesi
OSH 14	2008	14,733		45,000 euro ishte fillimi gjoba në fillim, shkeljes së kriterit për fillim të transmetimit të programit pa të drejtat e autorit.	Ka mbetur borxhi prej 14.733 euro pasi nuk ka arritur të kryej obligimet dhe lënda është ne gjykatë.
OSH 15	2009	26,430		Borxh nga viti 2017 deri në vitin 2021 shkelje të rregulloreve të ndryshme, si shkelje të Ligjit për Zgjedhjet dhe rregullores për komunikime komerciale audiovizuale.	Mos aplikimi i gjobës në mënyrë progresive.
OSH 16	2009	8,172	7,162	1,000 euro gjoba nga viti 2012 deri 2022 për shkelje të kriterëve të licencës siç është ndërrimi i vendodhjes së transmetuesit pa miratim paraprak.	Lënda në gjykatë dhe tek përmbaruesi.

⁴⁸ Raporet dhe të dhënat nga KPM përgjatë viteve 2008 - 2022.

				Një nga arsytet e borxhit është mosdorëzimi i raportit vjetor.		
OSH 17	2009	10,072	9,072	1,000 euro ka të bëjë me shkelje të ligjit për mos dorëzimin e raporti vjetor.	Lënda në gjykatë dhe tek përmbaruesi.	
OSH 18	2016	2,000		shkelje të Ligjit të KPM-së për ritransmetim të kanaleve pa marrëveshje valide dhe për mos dorëzim të raportit. Gjobat janë në vitin 2022.		
OSH 19	2010	11,364	10,364	1,000 euro për mos sjellje të raportit vjetor.	Lëndët janë në gjykatë dhe tek përmbaruesi.	
OSH 20	2010	10,111	7,111	3,000 euro gjoba për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet në Kosovë dhe mos dorëzim të raportit vjetor.		
OSH 21	2009	15,638	4,638	11,000 euro gjoba për shkelje të komunikimeve komerciale audiovizuale, vendosje të produkteve.		
OSH 22	2008	14,374		Për shkelje të rregullores për komunikime komerciale dhe shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, shkelje të Kodit të Etikës dhe shkelje të rregullores për komunikime komerciale dhe audiovizuale.		
OSH 23	2015	46,477	46,477		Proceduar tek Përmbaruesi.	
OSH 24	2008	20,000	20,000		Proceduar tek përmbaruesi.	

OSH 14 - i pajisuar me licencë në vitin 2008, një tjetër subjekt mediatik i cili ka shkelur kushtet e licencës, kishte një borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 14,733 eurove duke filluar nga viti 2013. Fillimisht KPM kishte shqiptuar gjobë në vlerë prej 45,000 euro ndaj këtij OSH për shkak të shkeljes së kriterit për fillim të transmetimit të programit pa të drejtat e autorit. Për rrjedhojë KPM kishte hyrë në marrëveshje me OSH-në që të paguajë borxhin me këste pa ndonjë bazë ligjore të qartë.

Deri në qershor të vitit 2023 OSH 14 nuk ka arritur të kryej të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së duke mbetur një borxh në vlerë prej 14,733 ndërsa lënda është në gjykatë.

OSH 12 - i pajisur me licencë me datë 28 gusht 2009 e ka një borxh total ndaj KPM-së në vlerë prej 252,000 euro (për të gjitha kanalet e OSH 12). Ky borxh është nga mos pagesa e tarifave vjetore përgjatë viteve dhe mos pagesa e gjobave.

Ne kemi analizuar tre gjoba me vlera më të mëdha në OSH 12 gjatë vitit 2010. Në mars të vitit 2010 OSH 12 është gjobitur me vlerë 50,000 euro lidhur me komunikimet komerciale dhe gjobën tjetër në vlerë 25,000 euro lidhur me vendosjen e produkteve. Në nëntor të 2010 Bordi për Ankesa të Mediave ka vendosur që të reduktoj gjobën nga 50,000 euro në 45,000 euro dhe gjobën tjetër nga 25,000 euro në 20,000 euro. Gjoba tjetër e cila ka ndodhur në shtator 2010 ka qenë në vlerë 50,000 euro, edhe kjo lidhur me komunikimet komerciale. Mirëpo në dhjetor Bordi për Ankesa të Mediave ka vendosur që kjo gjobë të zvogëlohet nga 50,000 euro në 40,000 euro. Vlera totale e këtyre borxheve në vitin 2010, pas zvogëlimit të vlerës ka qenë në total 105,000 euro. Komisioni i Pavarur për Media në nëntor 2013, ka pranuar një kërkesë nga OSH 12 për mundësimin e pagesës së gjobës totale me këste nga 35,000 euro në vit, duke filluar nga viti 2014, me arsyetimin se gjendja financiare e OSH 12 nuk është e mirë. Mirëpo, Bordi për Ankesa në pajtim me palën ankuese gjatë vitit 2015, kanë vendosur që këto gjoba të zvogëlohen tutje (gjoba e parë 50,000 euro në 35,000 euro, gjoba e dytë 25,000 euro në 15,000 euro dhe gjoba e tretë 50,000 euro në 35,000 euro) duke e bërë totalin gjobave për këto tri raste në vlerë 85,000 euro dhe duke i mundësuar të bëjnë pagesën e borxhit me këste mirëpo pa një bazë ligjore.

Edhe gjatë vitit 2017 OSH 12 është gjobitur në vlerë 1,000 euro për transmetim të spoteve politike me pagese të cilat nuk janë identifikuar se nga kush janë të sponsorizuara. KPM kishte vlerësuar se OSH 12 ka shkelur politikat redaktuese të saja për shkak se lajmi i publikuar nuk ka përmbajtje informuese e me qëllime tendencioze për cenimin dhe denigrimin e personalitetit. KPM në vitin 2018 përmes një shkrese e ka njoftuar RTK se e ka pranuar ankesën dhe ka kërkuar sqarime lidhur me pretendimet. Po ashtu KPM ka monitoruar OSH 12 dhe në bazë të raportit të monitorimit në vitin 2019 ka gjetur se ka vepruar në kundërshtim me kodin e etikës dhe e ka njoftuar palën duke e sanksionuar me gjobë në vlerë prej 5,000 euro.

Po ashtu, edhe në vitin 2021 KPM kishte gjetur se OSH 12 kishte bërë shkelje të dispozitave gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të vitit 2021.

Në shtator 2021 KPM pas monitorimit ka gjetur se e njëjta ka vazhduar të jetë në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme⁴⁹ në Republikën e Kosovës. Po ashtu edhe pas kësaj KPM ka njoftuar OSH 12 për të gjeturat dhe ka kërkuar që të veproj në harmoni me ligjin. Në tetor 2021 KPM ka gjetur se OSH 12 prap ka vazhduar me shkeljen e dispozitave të njëjta. Po ashtu, në tetor 2021 KPM ka gjetur se e njëjta ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës të KPM⁵⁰. Për shkak të shkeljes së kritereve sikurse janë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të tjera është shqiptuar gjobë në vlerë prej 2,000 euro.

Bazuar në gjetjet më lartë si arsyetime kemi pranuar nga KPM për rastet të cilat janë shqiptuar gjoba të ndryshme, se Komisioni është i cili vendos duke vlerësuar se çfarë gjoba duhet t'iu vendosin OSH-ve dhe se gjobat ndryshojnë në vlerë në varësi të rëndësisë dhe përsëritjes së shkeljeve. Në fillim ndaj OSH-së është vendosur gjobë më e ultë ndërsa nëse OSH nuk ka ndërmarrë hapa për të mos e përsëritur të njëjtën shkelje është vendosur gjobë më e lartë nga Komisioni. Komisioni në raste të caktuara është munduar të vendosë gjoba në mënyrë progresive, megjithatë kemi vërejtur se në një rast edhe pse gjobat viteve të kaluara ishin më të larta për të njëjtën shkelje, Komisioni ka vendosur gjobë më të ultë edhe pse është bërë shkelja e njëjtë në vitet më vonë.

Vlerësojmë se në këtë ka ndikuar Ligji i KPM-së i cili nuk precizon qartë vlerën e gjobave mirëpo ka lënë një mundësi të ndëshkimit nga 1,000 - 100,000 euro dhe për vlerën e vendosjes së gjobës në diskrecion të Komisionit.

Lidhur me mungesën e pezullimeve dhe revokimeve të licencave për OSH-të të cilat nuk kanë paguar tarifat vjetore të licencave dhe gjobat, KPM ka dhënë arsyetime se janë ndërmarrë hapa lidhur me revokim të licencës për disa OSH të cilat nuk i janë përmbajtur kritereve për shkelje të rregulloreve apo për mos pagesë të borxheve. Megjithatë kemi vërejtur se rastet e tilla janë kur ofruesit e shërbimeve media audio vizuale nuk kanë transmetuar dhe nuk kishin fare aktivitet mediatik dhe për pasojë KPM ka ndërprerë/revokuar licencën, ndërsa për rastet e OSH-ve të cilat ishin mostra të auditimit dhe janë vlerësuar shohim se KPM nuk ka ndërmarrë asnjë hap të tillë për pezullim apo dhe revokim të licencës për shkak të borxheve ndaj KPM-së.

Në lidhje me këtë, KPM ka dhënë si arsyetime se KPM nuk ishte e orientuar që të bëjë tërheqjen apo pezullimin e licencave të mediave mirëpo kishte mundësuar OSH-ve të caktuar që borxhet e akumuluar përgjatë viteve për mungesë të pagesës së tarifës vjetore dhe gjobave ti kryejnë përmes kësteve.

⁴⁹ Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, nenin 49 paragrafi 6 të Kreut VIII .

⁵⁰ Kodit të Etikës KPM 2016/03, nenin 9 paragrafi .

Vlen të theksohet se me datë 19.07.2023, KPM ka nxjerr një vendim lidhur me borxhet e OSH-ve i cili thekson se të gjithë subjektet e licencuara duhet të paguajnë borxhet e papaguara të taksës ose gjobës brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Ata, gjithashtu mund të lidhin marrëveshje me përmbaruesin privat për të garantuar përmbushjen e obligimeve të tyre financiare ndaj KPM-së brenda 12 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Nëse subjektet e licencuara nuk përmbushin këto kushte, atyre mund t'iu ndërpritet ose të mos i'u rigjenerohet licenca sipas Ligjit të KPM-së.

Në rastet kur OSH-të nuk kanë dorëzuar raportet vjetore dhe financiare, arsyetimet e KPM-së janë se në këto raste shqipton gjobë sipas rregullores për mos zbatim të këtij kriteri duke lejuar që OSH-të të vazhdojnë aktivitetet e tyre mediatike pa plotësimin e këtij kriteri të rëndësishëm edhe në vitet e ardhshme. Edhe në rastet kur OSH kanë sjellur raportet vjetore në KPM kemi vlerësuar se këto raporte nuk ofrojnë të dhëna mjaftueshëm të detajuara të cilat tregojnë mbi gjendjen financiare të OSH-ve. Për më tepër KPM nuk ka ndërmarrë ndonjë hap konkret për të bërë kontroll/cross-check përmes Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për të vlerësuar nëse të dhënat e paraqitura janë njëjtë apo edhe për të siguruar përmes ATK-së gjendjen financiare të OSH-ve dhe krahas kësaj të marrë vendime për pezullim apo revokim të licencave. Mund të përfundojmë që KPM nuk ka shfrytëzuar mekanizmat e saj të brendshëm për ti paraprirë gjendjes së tanishme të krijuar me borxhet.

Disa OSH të medias audio-vizuale janë përballur me pezullim ose revokim për shkak të mosveprimtarisë, të tjerë OSH nuk janë përballur, ku për pasojë, kemi borxhe të akumuluar të OSH-ve nëpër vite dhe KPM nuk ka arritur ti mbledh as përmes marrëveshjeve për pagesë të kësteve dhe as përmes përmbaruesit në mënyrë efektive. Për më tepër, kjo qasje jo mjaft rigoroze ndaj OSH-ve që nuk dorëzojnë raportet e tyre vjetore dhe financiare, së bashku me raportet e pamjaftueshme të detajuara, i ka lejuar OSH-të të vazhdojnë aktivitetet e tyre mediatike pa përmbushur kriteret thelbësore, duke kontribuar në akumulimin e borxhit.

3.4 Dobësitë në mbledhjen e borxheve të OSH-ve nga ana e KPM-së

Ofruesit e shërbimeve obligohen që të paguajnë tarifën vjetore dhe gjobat ndaj KPM-së. KPM në rastet e mos kryerjes së obligimeve duhet të shfrytëzojë mekanizmat e saj ligjor duke dërguar lëndët në gjykatë dhe tek përmbaruesit privat. Afati i fundit për pagesën e taksës dhe pagesat e gjobave nga ofruesit e shërbimeve ndaj KPM-së është data 30 qershor të vitit respektiv⁵¹.

Në tabelën 3 janë paraqitur borxhet e pambledhura nga KPM të tetë OSH-ve përgjatë viteve 2008-2022, përfshirë edhe gjashtë mujorin e vitit 2023. Kjo analizë është bërë për të vlerësuar gjendjen e përditësuar dhe reale të borxheve dhe të njëjtën kohë për të shqyrtuar se a ka

⁵¹ Ligji për Komisionin e Pavarur për Media dhe sipas rregulloreve të KPM-së.

ndërmarrë KPM hapa konkret dhe nëse ka shfrytëzuar të gjitha mekanizmat ligjor për të mbledhur këto borxhe. Për nevoja krahasimore referuar raportit të përmbartuesit është vlerësuar edhe gjendja e borxheve të mediave të tjera përveç këtyre të përmendura për të identifikuar problemet në mbledhjen e borxheve. Në tabelën 4 kemi paraqitur disa nga OSH-të të cilat kishin borxhe dhe vonesa të theksuara në procedimin e lëndëve për përmbartim nga KPM-ja.

Tabela 3. Ofruesit e shërbimeve të cilët kanë borxhe ndaj KPM-së në vlera të ndryshme përgjatë viteve 2008 - 2022 dhe të cilat nuk janë mbledhur nga KPM.





Tabela 4. Vonesat në procedimin e lëndëve tek përmbartuesi nga KPM për mostrat e audituara përgjatë viteve 2008 deri në vitin 2022.

Ofruesi i shërbimit	Borxhi dhe viti	Procedimi tek përmbartuesi	Vonesat
OSH 16	Borxh, 2014 - 599 €	Maj, 2017	3,5 vite
	Borxh, 2015 - 540 €	E proceduar për përmbartim në vitin 2017	Afërsisht 2 vite
OSH 20	Borxh, 2014 - 1,398 €	Maj, 2017	3.5 vite
OSH 17	Borxh, 2014 - 2,097 €	Maj, 2017	3 vite
OSH 27	Borxh, janar 2020 - 500 €	Shator, 2020	3 muaj vonesë
OSH 21	Borxh, shkurt 2021	Gusht, 2021	2 muaj vonesë

Arsyet e vonesave nga KPM për procedim të përmbaruesi janë se ka filluar t'i iniciojë rastet e mospagesës së tarifës vjetore dhe gjobave tek përmbaruesit privat në maj 2017, duke i përcjellur të gjitha rastet që nga viti 2014 deri në vitin 2017. Sipas KPM-së për rastet e OSH 21 dhe OSH 27, në përgjithësi nuk kishte një datë specifike se kur të dërgohen lëndët në përmbarim, kompletimi i lëndëve dhe raportet me të dhënat e pagesave dhe mos pagesave kishte marrë kohë. Kjo pasi që KPM kishte dhënë afat për OSH-të për të deklaruar nëse do t'i paguajnë borxhet apo jo. Megjithatë vlerësojmë se KPM ka proceduar borxhet me vonesë tek përmbaruesi duke lejuar akumulimin e tyre. Para vitit 2019 rastet e borxheve të akumulura janë vonuar me vite për dërgim të përmbaruesi nga KPM, ndërsa pas vitit 2019 këto vonesa janë për disa muaj.

Për të kuptuar natyrën e vonesave të mbledhjes së borxheve përmes gjykatës dhe përmes përmbaruesit kemi vlerësuar minutat e takimit të Komisionit të KPM-së me përmbaruesin dhe raportin e përmbaruesit të vitit 2023. Gjatë takimit të KPM-së me përmbaruesit, u raportua se disa OSH kishin llogari bankare joaktive, duke penguar arkëtimet. Të tjerët ishin në pritje të vendimeve të gjykatës. Përmbaruesi ka ndërmarrë veprime, si bllokimi i llogarive të ofruesve të shërbimeve dhe konfiskimi i pajisjeve mediatike. Megjithatë, mbledhja e aseteve është komplekse për shkak të mungesës së një depoje. KPM ka pyetur për tarifën kontestuese të licencës ku edhe eksperti privat shpjegoi të drejtën e tyre ligjore për ankesë. Kontrollat e brendshme të KPM-së janë të mangëta, duke rezultuar me vonesa dhe pengesa në trajtimin e rasteve të mospagesës dhe akumulimin e borxhit.

Grafikoni 5. Problemet në mbledhjen e borxheve të OSH-ve nga ana e përmbaruesit.



Për nevoja krahasimore referuar raportit të përmbaruesit është vlerësuar edhe gjendja e borxheve të mediave të tjera përveç këtyre të përmendura. Sipas raportit shumica e lëndëve janë në prapësim pasi që mediat janë ankuar në gjykatë. Në këtë raport janë identifikuar 43 raste tjera ku janë bllokuar llogaritë e mediave pasi që mediat nuk kishin mjete në bankë. Ka raste të cilat nuk kanë gjetur adresën e mediave.

Kjo ka kontribuar në grumbullimin e borxheve. Për më tepër edhe nga intervistat e zyrtarëve në KPM (menaxhmenti dhe zyrtar të tjerë) kemi kuptuar se asnjëherë nuk kishte për qëllim pezullimin e licencave apo mbylljen e ndonjë medie për arsye financiare pasi që kjo mund të shkaktoj një kaos mediatik.

Vonesat në procedim të përmbaruesi nga KPM-ja kanë efekt në akumulimin e borxhit duke ndikuar në stabilitetin financiar të OSH-ve dhe duke penguar zbatimin efektiv të mbledhjes së borxhit.

3.5 Revokimet e Licencave të ofruesve të shërbimeve mediatike nga KPM

Në vitin 2021 është aprovuar rregullorja për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale⁵² e cila ka hyrë në fuqi në dhjetor 2021, ku sipas kësaj rregullore, të gjithë ofruesit e shërbimeve mediale dhe audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes të cilët nuk janë duke transmetuar obligohen që të fillojnë transmetimin e programeve brenda afatit prej 90 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore në të kundërtën do t'iu pezullohet licenca.

Kemi analizuar të gjitha tetë mostrat e revokimeve të licencave të OSH-ve nga KPM përgjatë viteve 2009 – 2022. Nga këto mostra kemi gjetur se procesi i revokimit të licencave po përcjellet me dobësi.

Në vitin 2013 përmes një shkresë⁵³, OSH 28 kërkoi pezullimin e licencës së transmetimit për shkak se nuk e kishin përdorur për dy vite dhe nuk mund të përballonin tarifat përkatëse. KPM nuk kishte marrë një vendim si rezultat i mungesës së plotë të bordit. OSH 28 kishte kërkuar më parë pezullimin e licencës në vitin 2012 për shkak të vështirësive financiare, por KPM nuk e kishte trajtuar kërkesën duke e ngarkuar OSH-në edhe për vitin 2013. Vetëm në maj 2013 KPM kishte pezulluar zyrtarisht licencën.

Kjo ka ndodhur pasi që sa i përket pezullimit të licencës, askund në legjislacionin primarë dhe sekondarë të KPM-së nuk ka qenë e paraparë pezullimi i licencës si mundësi për të licencuarin (ashtu siç ka kërkuar i licencuar që përkohësisht ti pezullohet) dhe për këtë është

⁵² Rregullorja KPM-2021/21, neni 22.

⁵³ E-Mail-in e datës 25 shkurt 2012.

njoftuar pala në takime si edhe çdo i licencuar tjetër i cili ka pasur kërkesë të ngjashme. Nuk ekziston mundësia e pezullimit të licencës për një periudhë kohore për ta aktivizuar përsëri licencën.

Prandaj, OSH 28 ka qenë e obliguar të paguaj taksën e tarifës sepse sipas KPM konsiderohej ende me licencë e vlefshme edhe pse nuk kishte transmetuar për periudhën e caktuar. Pastaj, KPM ka marr vendim për ndërprerjen e licencës vetëm në momentin kur pala ka kërkuar heqje dorë nga licenca⁵⁴. Njëra nga arsytet e vonësës në trajtim nga KPM ishte se deri në vitin 2021 nuk kishte një afat specifik për fillimin e transmetimeve, andaj kjo ka bërë që mos të trajtohet në mungesë të kriterëve të qarta.

Në mungesë të monitorimit të rregullt dhe vlerësimit të gjendjes së OSH-së, KPM nuk ka arritur që me kohë të vlerësoj dhe të merr parasysh kërkesat dhe nevojat e OSH-së për ndërprerjen dhe pezullimin e licencës andaj për pasojë është akumuluar borxhi në vlerë prej 6,974 euro.

Në rastin tjetër, në vitin 2009 KPM ka pajisur me licencë OSH 29. Bazuar në raportin e monitorimit të vitit 2022, KPM kishte vërtetuar se disa OSH përfshirë edhe OSH 29 nuk janë duke transmetuar. Bazuar në të dhënat e borxheve kemi vërejtur se kjo OSH kishte borxhe nga viti 2018 deri në vitin 2022 lidhur me mospagesën e tarifës vjetore dhe gjoba. Në mungesë të monitorimit të mëhershëm, KPM nuk ka arritur që të vërtetoj me kohë nëse është duke transmetuar apo jo dhe deri në vitin 2021 kur është aprovuar rregullorja për fillimin e transmetimit nuk e kishte ngritur këtë çështje, ku për pasojë ishin akumuluar borxhet. Si rrjedhojë, në janar të vitit 2022 Departamenti i Licencimit ka kërkuar OSH 29 që të vazhdojë me transmetim mirëpo nëse nuk shprehin interesim për të vazhduar transmetimin duhet të bëjnë kërkesë për ndërprerje të licencës. Në gusht 2022, sipas raportit të monitorimit të dytë KPM ka gjetur se OSH 29 nuk ka respektuar afatin prej 90 ditësh për të filluar me transmetim ashtu siç është përcaktuar me rregullore. Po ashtu, ofruesi i shërbimit ka dështuar të kryej pagesën për licencë për vitet 2018 deri 2021 dhe një gjobë në total në vlerë prej 4,500 euro. KPM ka marrë vendim që të ndërpresë licencën dhe ka lëshuar vendim që pala është e detyruar që të shlyej obligimet.

Sipas KPM-së në shumë raste mbajnë takime me të licencuarit për çështje të ndryshme dhe po ashtu në vitin 2021 kanë mbajtur takim me përfaqësuesin e OSH 29 duke i njoftuar se duhet të paguhet të gjitha obligimet financiare.

Lidhur me procedurat për ndryshim të pronësisë për këtë OSH, KPM ka njoftuar se një ndër kriteret për këtë ndryshim është pagesa e të gjitha obligimeve financiare. Ndërsa në anën tjetër përfaqësuesit nga OSH 29 janë shprehur se ky televizion ka probleme financiare

⁵⁴ Kërkesa e datës 16 dhjetor 2013.

dhe për këtë arsye ka probleme edhe me transmetimin e programit (për të cilat KPM nuk na kishte ofruar dëshmi për problemet financiare me të cilat ballafaqohet ky OSH) .

Mungesa e monitorimit mediave në mënyrë konsistente nga ana KPM-së ka ndikuar që mos të identifikohen me kohë nëse janë duke transmetuar kështu me qëllim që të parandalohet mbledhja e borxheve. Po ashtu të identifikojë se obligimet financiare me kohë lidhur me obligimet e tarifave të ofruesve ndaj mediave nuk janë duke u kryer, ku për pasojë ka lejuar që të mbledhen borxhet dhe të rrezikoj mbledhjen e mjeteve.

4. Konkluzionet

Procesi i menaxhimit të licencave të OSH-ve nga Komisioni i Pavarur për Media është në një nivel të ultë, duke ndikuar që kriteret për aktivitetet mediatike të mos zbatohen. Mediat veprojnë pa përmbushur obligimet financiare të tarifave vjetore përgjatë viteve dhe pezullimet e licencave të mediave nuk realizohen me kohë nga KPM, ku për pasojë kanë grumbullimin e borxheve. Në grumbullimin e borxheve ka ndikuar mungesa e monitorimit të mediave me kohë dhe në mënyrën e duhur dhe ndërmarrja e hapave konkret ndaj atyre mediave të cilat nuk zbatojnë kriteret dhe anashkalojnë pagesat e trafiave vjetore. Për më tepër ka vonesa të theksuara në mbledhjen e borxheve dhe probleme në kontrollet e brendshme të autoritetit të mediave.

KPM ka mundur pajimin me licenca të ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale duke u treguar e pakujdesshme në zbatimin e kriterëve të nevojshme duke rrezikuar mbarëvajtjen e procesit.

Në disa raste KPM ka lejuar pajisjen me licenca në mungesë të marrëveshjeve valide për të drejtën e transmetimit ku për disa kanale nga lista për bartje të obligueshme, mungojnë marrëveshje të transmetimit. Në disa raste të tjera kanalet e obligueshme nuk ishin prezantuar fare në listën e kanaleve, ku gjithashtu kishte edhe mungesë të kontratave me ofruesit e shërbimeve mediale duke rrezikuar transmetimin.

Gjatë procesit të ripërtëritjes së licencave kishte shkelje të dispozitave materiale në lidhje me kriteret e licencimit. Këto shkelje përfshinin mungesën e provave të dokumentuara lidhur me pagesën e taksës vjetore në dosje. Mediat nuk arritën t'i përmbahen afateve të rinovimit të kontratës. Njëkohësisht, KPM-ja, në rolin e mbikqyrësit, vazhdoi me ripërtrirjen e licencave të mediave pa marrë asnjë masë për përmirësimin e këtij procesi apo adresimin e problematikave të evidentuara.

KPM nuk është konsistente në dhënien e rekomandimeve për ripërtëritjen e licencave të mediave. Rekomandimet për ripërtëritje janë të ndryshme, ku në disa raste mediat me obligime financiare nuk i janë evidentuar fare në rekomandim për ripërtrirje, përderisa në rastet kur OSH-të ishin në përputhje me rregullat, arsyet pasqyronin me saktësi respektimin e tyre ndaj detyrimeve financiare. Po ashtu në këtë rekomandim për ripërtëritje KPM ka anashkaluar shkeljet e kriterëve dhe parregullësitë duke qënduar indiferente në këtë proces. Nuk janë aplikuar vendimet e standardizuara gjatë këtij procesi ndaj OSH-ve.

Vonesa të konsiderueshme janë identifikuar në procesin e vendimmarrjes për ripërtëritje të licencave të cilat kryesisht janë për mungesë të kuorumit të Komisionit të KPM-së. KPM ishte neglizhente në marrjen e vendimeve brenda afateve kohore. Këto vonesa në ripërtëritjen e licencave përfshijnë ndërprerjet e mundshme të shërbimeve të transmetimit, paaftësinë për të monitoruar dhe pamundësinë e rregullatorit për të sanksionuar në rast shkeljeje të rregullores apo kushteve të punës.

Kontrollet e brendshme në KPM nuk janë efektive pasi që departamentet brenda KPM-së nuk janë të vëmendshme për të përcjellur transmetimin e OSH-ve duke lejuar akumulimin e borxheve nga tarifat vjetore dhe gjobat përgjatë viteve. Si rezultat, nuk pezullohen licencat e mediave dhe OSH-të vazhdojnë aktivitetet e tyre edhe përkundër obligimeve financiare dhe shkeljes së kritereve.

KPM nuk kishte bërë monitorimin me kohë të OSH-ve për të vërtetuar nëse është duke transmetuar apo jo përgjatë viteve. Në mungesë të monitorimit të rregullt dhe vlerësimit të gjendjes së ofruesve të shërbimeve KPM nuk ka arritur që me kohë të vlerësoj dhe të marrë parasysh kërkesat e ofruesit të shërbimeve për ndërprerjen dhe pezullimin e licencës dhe për pasojë janë akumuluar borxhe.

5. Rekomandimet

Komisioni i Pavarur për Media duhet të rrisë nivelin e menaxhimit të licencave të OSH-ve dhe të zbatojë një proces më të mirë në menaxhimin e mediave përmes:

1. Fuqizimit të sistemit të licencimit dhe monitorimit i cili është thelbësor për të siguruar që operatorët e shpërndarjes t'i përmbahen të gjitha kriterëve të licencimit dhe realizimit të shërbimeve.
2. Zbatimit të afateve të qarta kohore dhe masave konkrete për vonesat apo devijimet nga kriteret në mënyrë që të parandalohen rreziqet që lidhen me ripërtëritjen e licencave.
3. Dhënies së rekomandimeve të qarta gjatë procesit të ripërtëritjes së licencave në mënyrë që të sigurojnë standardizim dhe konsistencë.
4. Shfrytëzimit efikas të mekanizmave siç janë, pezullimi, ndërprerja/revokimi i licencave ndaj OSH-ve të cilat nuk zhvillojnë aktivitete transmetuese, nuk kryejnë obligimet financiare dhe bëjnë shkelje të kriterëve mediatike.
5. Rritjes së monitorimit të OSH-ve për aktivitetet e tyre transmetuese duke koordinuar veprimet në mes të departamenteve në KPM për një mbikqyrje efektive të licencave dhe pagesave.

I. Shtojca I. Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Motivi i Auditimit

Sipas të dhënave nga KPM të cilat i kemi pranuar, vetëm borxhi i **OSH 12** është 252,619 euro në krahasim me totalin ërej 795,970 euro apo afërsisht 32% e vlerës totale. Vlera LL/A-ve, në krahasim me vitin paraprak shënon rritje në vlerë ërej 67,702.87 euro (728,267.08 euro në vitin 2021) apo 9.30%.

Obligimet për tarifën vjetore për Licencë për periudhën 2011-2013 janë proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore dhe për vitet 2014-2022 janë proceduar të përmbaruesi privat.

Deëartamenti Ligjor i KPM-së gjatë vitit 2022 ka dërguar në përmbarim 50 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuele të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2022. Po ashtu, në përmbarim janë dërguar edhe dhjetë (10) raste për mos pagesë të gjobave të shqiptuara nga Komisioni i KPM-së.⁵⁵

Nga të dhënat lartë mund të konkludojmë që KPM ka hasur në probleme lidhur me arkëtimin e mjeteve nga licencat/tarifat dhe nga gjobat ndaj mediave.

Për më tepër, vështirësitë në proces të licencimit kanë ndodhur kryesisht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve financiare. Tarifat e licencimit janë një burim kryesor i financimit dhe nëse mediat nuk paguajnë tarifën e tyre të licencimit shkaktojnë detyrime ligjore dhe ekonomike të konsiderueshme.

Kjo çështje po ashtu ndikon drejtëprdrejt në procesin e ripërtëritjes të këtyre mediave. Operatorët e mediave janë të detyruar të plotësojnë detyrimet financiare për të përmbushur kushtet e ripërtëritjes.⁵⁶ Këto detyrime përfshijnë pagesën e tarifave, taksave dhe kontributeve të tjera të caktuara nga KPM. Është e rëndësishme që operatorët të kenë paraqitur dokumentacionin dhe të kenë paguar shumën e kërkuar në përëuthje me rregulloret e aplikueshme.

Shqyrtimi i indikatorëve të problemeve të identifikuara më lartë na shpijnë në formulimin e problemit të auditimit si në vijim: KPM-ja, përgjegjëse për licencimin e mediave dhe mbledhjen e tarifave të licencave dhe gjobave nga mediat, përballet me vështirësi në ri licencimin e mediave kryesisht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve

⁵⁵ Raprti vjetor i punës KPM 2022, fq 49.

⁵⁶ KPM 2017/02 Rregullore për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele Neni 25.

financiare dhe mbledhjen efektive të këtyre fondeve, duke rezultuar në detyrime të papaguara.

Po ashtu, Kuvendi i Kosovës ka parashtruar kërkesë për auditimin e menaxhimit të licencave nga KPM-ja.

Kriteret e Auditimit

Në vazhdim janë paraqitur kriteret për pyetjet e paraqitura, megjithatë në fazën e ekzekutimit do të shqyrtojmë dhe përdorim edhe kritere tjera relevante nëse do të vlerësohen të rëndësishme në lidhje me auditimin. Në vazhdim janë paraqitur kriteret krahas pyetjeve të auditimit.

1. A janë lëshuar licencat e mediave prgjatë viteve 2008 – 2022 nga KPM në pajtim me proceset dhe procedurat e përcaktuara?

Departamenti i Licencimit në KPM është përgjegjës dhe duhet të bëjë shqyrtimin dhe procedimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale dhe operatorë të shpërndarjes, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve të licencës së KPM-së si dhe atyre për ripërtëritje të licencës. Gjithashtu, ky departament është përgjegjës për mbajtjen dhe mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së i cili, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për KPM-në, është në dispozicion të publikut përmes ueb faqes së KPM-së.⁵⁷

Ofruesit e shërbimit medial audio dhe audiovizuel mund të parashtrojnë kërkesë pa konkurs në çdo kohë tek KPM ndërsa me transmetim tokësor bëhet Përmes Procedurës së konkursit Publik⁵⁸.

KPM-ja me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të parashtruara për licencat e transmetimit, duhet të marrë parasysh kriteret si: kapacitetin për zhvillimin e programit vetanak; ërejardhjen dhe shkallën e burimeve financiare të aëlikantit; realizueshmërinë financiare të ëroëozimit të aëlikantit; kapacitetin teknik të aplikantit për të ofruar transmetim cilësor; nevojën për të siguruar program të shumëllojshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës.⁵⁹

Kriteret për parashtruesin e shërbimit medial audio dhe audio vizual kryesisht përfshijnë kriteret programore, kriteret ekonomike, dhe kriteret teknike.⁶⁰

⁵⁷ Raporti vjetor i punës për vitin 2021 nga KPM, fq 56.

⁵⁸ Rregulore për Ofruesit e Shërbimit Medial Audio dhe Audiovizuale 2021, neni 8 dhe 11.

⁵⁹ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 aplikimet për licencat e transmetimit.

⁶⁰ Rregullore për Ofruesit e Shërbimeve Mediale audio dhe Audiovizuale 2017 dhe 2021.

Zyra Ekzekutive duhet të mbajë një regjistër të licencave të transmetimit, ku përfshihen kushtet e aplikueshme për secilën licencë. Regjistri i licencave duhet të jetë në disëozicion për publikun.⁶¹

Në rast të mos përmbushjes së kriterëve të parashtruesit të kërkesës KPM duhet të bëjë diskualifikimin e ëarashtruesit për licencë duke dhënë arsyet e diskualifikimit.⁶²

Lëshimi i licencave për shërbime mediale audio vizuale

KPM duhet të lëshoj vendimet mbi refuzimin ose mos ripërtëritjen e licencës për ofruesin e shërbimit media audio vizuale dhe duhet të jenë të arsyetuara me shkrim dhe ato u dorëzohen aplikantëve nëpërmjet Zyrës Ekzekutive.

Praktikë e mirë - Ofruesi i shërbimit duhet të paraqes garanci bankare në vlerën e pagesës vjetore të taksës vjetore për licencë. Kjo shumë e garancionit duhet të mbetet e ngurtësuar për një periudhë 9 mujore duke filluar nga data e aplikimit. Në rast se aplikuesi pajiset me licence vlere e ngurtësuar kalon menjëherë në llogari të KPM si pagesë për vitin e parë të licencimit.⁶³

2. A janë respektuar dispozitat ligjore për përmbushjen e detyrimeve financiare dhe gjatë ri licencimit të operatorëve për periudhën 2008 – 2022?

Tarifat vjetore

KPM-ja duhet të caktoj një skemë për tarifin e licencës, për kategori të ndryshme të licencave të transmetimit që do të paguhet për çdo vit nga të licencuarit. Tarifa e licencës do të jetë e njëjtë në kuadër të çdo kategorie të licencave⁶⁴.

Taksa Vjetore për licencë për shërbime mediale audio-vizuale duhet të paguhet dhe të depozitohet në baza vjetore, në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media në muajin e parë të vitit respektiv. Në rast të pagesës së taksës me vonesë, personi me licencën e lëshuar për transmetim të shërbimeve mediale audio – vizuale do të paguajë kamata për vonesë të pagimit të taksës në pajtim me Ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës. Mos pagimi i taksës do të rezultojë në sanksionim të subjektit transmetues në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë edhe me revokim të licencës⁶⁵.

Ripërtëritja e licencave - Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtërihet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel ërivat, për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati

⁶¹ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 Aplikimet për licencat e transmetimit.

⁶² Rregullore për Ofruesit e Shërbimit Medial Audio dhe Audiovizuale 2021, neni 20.

⁶³ Autoriteti i Mediave Audiovizive (Shqipëri) – Vendim për miratimin e rregullores. Neni7, paragrafi 2, 3 dhe 4.

⁶⁴ Rregullore për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediale audio – vizuale.

⁶⁵ Rregullore për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediale audio – vizuale, neni 6.

ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.⁶⁶

Licencat e transmetimit dhe riërtëritja e tyre bëhet për një afat shtatë (7) vjeçar për radio transmetime, ndërsa afati dhjetë (10) vjeçar është për shërbime mediale audiovizuale dhe për operatorët e rrjeteve për ofrimin e shërbimeve mediale me përmbajtje audiovizuale.⁶⁷

Shkelja e kushteve të licencës

KPM-ja duhet të monitoroj shërbimet mediale audiovizuale dhe mund të iniciojë dhe të pranojë ankesa përkitazi me mosveërimin në përputhje me kushtet e licencës, kodit të sjelljes, dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj. KPM-ja do t'i shqyrtojë ankesat që pohojnë shkeljen e kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj. KPM-ja përmes Zyrës Ekzekutive e njofton subjektin transmetues me shkrim për çdo pohim lidhur me shkeljen e kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve tjera juridike, dhe siguron që subjekti transmetues të ketë mundësi të arsyeshme për të bërë prezantim dhe për të paraqitur dëshmi. Pas përfundimit të hetimit, KPM-ja nxjerr vendim duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit përkatës⁶⁸.

Afati për pagesën e tarifave vjetore të licencuarve të KPM-së është 30 qershor i vitit respektiv.⁶⁹

Në rastin e licencimit të ofruesit të shërbimeve mediale audio-vizuale taksa e parë vjetore për licencë do të paguhet jo më vonë se 14 ditë nga pranimi i vendimit për licencim⁷⁰.

3. A ka ndërmarrë KPM hapa konkret për të pezulluar licencat e mediave në rastet e mos përmbushjes së obligimeve financiare dhe mos zbatimit të kriterëve programore?

Subjektet e licencuara duhet të veprojnë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, në përputhje me politikat transmetuese, në pajtueshmëri të plotë me të gjitha aktet nënligjore si dhe me kushtet dhe termet e licencës, siç janë të përcaktuara nga KPM-ja.⁷¹

KPM duhet të mbledh taksat për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese nga subjektet e licencuara për shërbime mediale audiovizuale dhe nga operatorët e rrjeteve⁷².

KPM duhet të zbatojë ërocedurat dhe kriteret e përcaktuara në ligjin e mediave për të vlerësuar aplikimet e operatorëve të mediave për ri licencim. Në këtë proces, do të

⁶⁶ Rregullore për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve audio dhe audiovizuale, neni 8.

⁶⁷ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 21, paragrafi 2.

⁶⁸ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 Aplikimet për licencat e transmetimit. neni 29.

⁶⁹ Raporti vjetori i punes, KPM, fq 72.

⁷⁰ Rregullore për pagesën e taksës, viti 2010, fq 3 neni 5.

⁷¹ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 Aplikimet për licencat e transmetimit. neni 21.

⁷² Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 22 Aplikimet për licencat e transmetimit. neni 3.

konsiderohen detyrimet financiare të operatorëve, përfshirë pagesat e tyre aktuale dhe të mëparshme, si dhe garancitë e ofruara.

Mos pagesa e taksës së licencës ndaj KPM-së, do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues, në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë edhe me revokim të licencës.⁷³

Për shkelje të kushteve të licencës, kodit të sjelljes dhe akteve tjera juridike në pajtueshmëri me këtë ligj, KPM-ja mund/duhet t'u lëshojë të licencuarve vërejtje me shkrim ose t'u shqiptojë një apo më shumë prej këtyre sanksioneve: t'i vendosë një gjobë në vlerë jo më pak se njëmijë (1.000) euro dhe jo më shumë se njëqindmijë (100.000) euro. Të kërkojë nga i licencuari që të transmetojë korigjimin ose të kërkojë falje përmes transmetimit; të kërkojë pezullimin e një pjese ose gjithë programin e të licencuarit për një periudhë të caktuar kohore; t'ia ndryshojë kushtet e licencës së transmetuesit; t'ia ndërpresë aëo refuzojë vazhdimin e licencës së transmetimit⁷⁴. Vërejtje për shkeljen e parë të një Rregullore të caktuar. Një aëo më shume dënime në përgjithësi do t'i paraprijnë çfarëdo suspendimi të licencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me një 2 vendim paraprak të KPM-së apo përsëritja e shkeljeve të njëjta do të rezultojë në dënime më të ashpra, duke përfshirë dënime më të mëdha në rritje për shkelje të rregullores së njëjtë apo të barasvlershme të KPM-së. Shkeljet e përsëritura apo të vazhdueshme të rregulloreve të KPM-së të cilat do ta justifikonin susëndimin e dytë brenda ëeriudhës dy vjeçare mund të shërbejnë si baza për revokim të licencës ⁷⁵.

4.A i ka zbatuar KPM në mënyrën e duhur të gjitha mekanizmat e lejuar ligjor për inkasimin e detyrimeve nga operatorët për periudhën 2008 -2022?

Departamenti Ligjor në kuadër të KPM-së duhet të inicioj rastet për në gjykatë dhe të shfrytëzoj mekanizmat tjerë (sikurse janë përmbaruesit) për të mbledhur të hyrat nga taksat dhe gjobat nga ofruesit e shërbimeve. Vendimet e Bordit për Ankesa janë përfundimtare dhe u nënshtrohen vetëm shqyrtimit procedural të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me ligjin në fuqi.⁷⁶ Për vitet pasuese taksa do të paguhet jo më vonë se 20 ditë pas fillimit të vitit kalendarik.⁷⁷ Taksat vjetore për lëshimin e licencës për transmetimin e sinjaleve radio dhe televizive do të paguhen jo më vonë se data 5 e muajit aktual. Vonesat në pagimin e taksës po ashtu kane ndëshkim me kamatë ndërsa mos pagimi i taksës do të rezultojë në sanksionimin e subjektit edhe me revokim të licencës⁷⁸.

⁷³ Rregullore 2010, për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediale audio - vizuale neni 5 fq 4.

⁷⁴ Po aty, neni 30.

⁷⁵ Udhëzimet e KPM-së në Zbatimin e Sanksipneve të Licencuarve **341** dhe 6.

⁷⁶ Ligji nr.04 L-44, për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 44.

⁷⁷ CIMC vendim per nivelin menyren e pecaktimit te pageses se taskes per licenim te operatoreve kabllore dhe fruesve te sherbimeve te programeve permes kablllos.

⁷⁸ Rregullore per taksa vitj 2007, fq5, neni 6 dhe Rregullore per taksa 2008 fq 5 dhe rregullore 2010 fq 4.

Fushëveprimi i auditimit

Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi është, Komisioni i Pavarur për Media dhe fokusi ishte në, Departamentin për Licencim, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës së Mediave (DMA) dhe Departamentin Ligjor dhe atë të Financave përgjegjësitë e të cilave janë të sqaruara në pjesën e përshkrimit të sistemit.

- Departamenti për Dhënie e Licencave,
- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës së Mediave,
- Departamenti Ligjor dhe i Financave.

Fushëveprimi ka mbuluar periudhën nga viti 2008 kur ka filluar dhënia e licencave nga KPM deri në vitin 2022, periudhë kjo e përfshirë në bazë të kërkesës së Kuvendit të Kosovës.

Metodologjia e auditimit

Metodologjia e përzgjedhur për analizimin e çështjeve të këtij auditimi përfshin ekzaminimin e të gjithë dokumenteve relevante duke filluar nga:

- Rregulloret për caktimin e kriterëve dhe për lëshimin e licencave 2009, 2013, 2014, 2017 dhe 2021, etj;
- Rregullore për vendosjen e taksave dhe mënyrën e pagesës së tyre;
- Shqyrtimi dhe analizimi i Raporteve Vjetore të punës së KPM-së 2022 etj;
- Shqyrtimi i Raporteve të Monitorimit lidhur me zbatimin e programeve nga ofruesit e shërbimeve;
- Vlerësimin e pajtueshmërisë së OSHMA-ve me rregulloren e KPM-së 2017;
- Aplikacionet e subjekteve të cilat kanë aplikuar për tu pajisur me Licencë për ofrimin e shërbimeve;
- Rishikimi dhe analizimi i gjobave të vendosura nga KPM ndaj ofruesve të shërbimeve;
- Analizimi i procedurave dhe mekanizmave të ndërmarra nga KPM përgjatë viteve në lidhje me mbledhjen e taksave dhe gjobave ndaj ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.

Përveç analizave të lartcekura janë zhvilluar edhe:

- Takime dhe intervista me zyrtarë përgjegjës për lëshimin e licencave, monitorimin e tyre dhe zyrtarët për mbledhjen e taksave dhe lëshimin e gjobave;
- Konsultim i literaturës, standardeve dhe praktikave të mira lidhur me menaxhimin e licencave të ofruesve të shërbimeve.

Pyetësor me media lidhur me të dhënat e obligimeve të mediave ndaj KPM-së dhe obligimet tjera.

II. Shtojca II. Rastet e borxheve të detajuara përfshirë natyrën e tyre dhe vlerat.

Fillimisht OSH 26 - i pajisuar me licencë në vitin 2008 , kishte një borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 13,000 euro, të gjitha gjoba për shkelje të kushteve të licencës dhe kriterëve programore përgjatë viteve. Nga këto borxhe kishte një gjobë në vlerë prej 5,000 euro të cilën e kishte shqiptuar me datë 11.02.2021, megjithatë shumën e kësaj gjobe pas shqyrtimit të ankesës nga OSH, e kishte ulur në vlerë prej 4,000 euro me arsyetimin për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19. Këtë borxh total në vlerë prej 13,000 euro, KPM e kishte proceduar tek përmbaruesi. OSH 26 në vazhdimësi kishte bërë shkeljen e kriterëve programore të rregullores për Komunikime Komerçiale⁷⁹.

OSH 13 - i pajisuar me licencë në vitin 2010, kishte një borxh ndaj KPM-së në shumën prej afërsisht 16,463 eurove duke filluar nga viti 2012 për shkelje të licencës dhe gjobë për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. KPM ka shqiptuar gjoba për shkelje të rregullave, ku ka mundur të bëjë pezullim të programeve apo licencës por nuk ka ndërmarrë këto masa efektive për të kryer obligimet financiare. Po ashtu edhe për këtë OSH, KPM kishte inicuar procedurën përmbarimore.

OSH 14 - i pajisuar me licencë në vitin 2008, një tjetër subjekt mediatik i cili ka shkelur kushtet e licencës, kishte një borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 14,733 eurove duke filluar nga viti 2013. Fillimisht KPM kishte shqiptuar gjobë në vlerë prej 45,000 euro ndaj këtij OSH për shkak të shkeljes së kriterit për fillim të transmetimit të programit pa të drejtat e autorit. Për rrjedhojë KPM kishte hyrë në marrëveshje me OSH-në që të paguajë borxhin me këste pa ndonjë bazë ligjore të qartë.

Deri në qershor të vitit 2023 OSH 14 nuk ka arritur të kryej të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së duke mbetur një borxh në vlerë prej 14,733 ndërsa lënda është në gjykatë.

OSH 15 - i pajisuar me licencë në vitin 2009, ka një borxh të akumuluar nga viti 2017 deri në vitin 2021 prej 26,430 eurosh ndaj KPM-së për shkelje të rregulloreve të ndryshme, si shkelje të Ligjit për Zgjedhjet dhe rregullores për komunikime komerciale audiovizuale. Kemi vërejtur se përgjatë viteve KPM ka tentuar të shqiptoj masa progresive sa i përket shkeljeve të kriterëve mirëpo në vitin 2021 po ashtu ka një shkelje të kriterit të njëjtë e cila ka të bëjë me komunikimet komerciale audiovizuale megjithatë ka shqiptuar gjobë më të ultë se në vitet 2019 dhe 2017.

KPM ka gjobitur televizionin disa herë për shkelje të njëjta dhe nuk ka ndërmarrë hapa të fuqishëm për të pezulluar programet e tyre ose për të revokuar licencën e tyre si mekanzëm efikas për të ndaluar shkeljet programore.

⁷⁹ Nenin 30 dhe neni 12.

OSH 16 - i pajisuar me licencë në vitin 2009, ka një borxh prej 8,172 eurosh ndaj KPM-së që nga viti 2012 për mos pagesën e tarifave vjetore dhe gjobave për shkelje të kriterëve të licencës siç është ndërrimi i vendodhjes së trasnmetiuesit pa miratim paraprak. Një nga arsyet e borxhit është mos-dorëzimi i raportit vjetor⁸⁰ në KPM. KPM ka ndërmarrë hapa ligjor siç janë gjykatat dhe përmbaruesit për të kryer mbledhjen e borxheve.

OSH 17 - i pajisuar me licencë në vitin 2009, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 10,072 euro. Të gjitha janë obligime për tarifa vjetore përgjatë viteve 2011 deri në vitin 2014 ndërsa një gjobë në vlerë prej 1,000 euro ka të bëjë me shkelje të ligjit për mos dorëzimin e raportit vjetor.

OSH 18 - i pajisuar me licencë 2016, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 2,000 euro. Me datë 26.09.2022 KPM ka sanksionuar me gjobë ofruesin e shërbimeve për mos dorëzim të raportit vjetor në KPM. Me datë 11.10.2022 po ashtu ka lëshuar gjobë në vlerë prej 1,000 euro për ofruesin e shërbimeve për shkelje të Ligjit të KPM-së për ritransmetim të kanaleve pa marrëveshje valide⁸¹. Gjithashtu është obliguar pala përgjegjëse që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi të bëjë ndërprerjen e kanaleve në ritransmetim.

OSH 19 - i pajisuar me licencë në vitin 2010, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 11,364 euro. Nga këto të gjitha janë tarifa vjetore ndërsa ka një gjobë në vlerë prej 1,000 euro me datë 06.08.2013 për shkelje për dështim në sjellje të raportit vjetor. Që nga viti 2012 OSH 19 nuk ka paguar licencën dhe për këtë është ngarkuar me kamatë për tri vite rresht deri në vitin 2014. Po ashtu edhe përgjatë viteve 2015 deri 2020 është ngarkuar me kamatë për mos pagesë të licencës. Po ashtu, ka dhe një gjobë në vlerë prej 1,000 euro për vitin 2013 për mos paraqitje të raportit vjetor në KPM, ku në total ka një borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 11,364.10 euro dhe vazhdon aktivitetin mediatik.

OSH 20 - i pajisuar me licencë në vitin 2010, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 10,111 euro. Të gjitha janë mos pagesa për tarifë vjetore ndërsa dy gjoba janë në vlerë totale prej 3,000 euro. Me datë 26.05.2021 pas monitorimit, KPM ka shqiptuar gjobë në vlerë prej 1,000 euro ndaj radios për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet në Kosovë, ndërsa me datë 26.09.2022 ka shqiptuar gjobën e dytë në vlerë prej 2,000 euro për mos dorëzim të raportit vjetor ndaj KPM-së.

OSH 21 - i pajisuar me licencë në vitin 2009, ka një detyrim/borxh në vlerë prej 15,638 euro ndaj KPM-së përgjatë periudhës 2019 deri në vitin 2021. Këto borxhe janë për tarife vjetore për licencë në vlerë prej 4,638 gjatë vitit 2020, për gjoba në vlerën prej 5,000⁸² euro gjatë

⁸⁰ Raporti vjetore financiar paraqet në mënyrë të detajuar gjendjen financiare të OSH-së lidhur me shpenzimet të hyrat dhe fitimet e OSH-së.

⁸¹ Në kuptim të nenit 30 paragrafi 2 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

⁸² Për shkelje të nenit 31 të Ligjit të KPM-së dhe nenit 15 të rregullores për Komunikime komerciale, vendimi me 11.02.2021

vitit.2021 e cila pas ankesës Brodi e ka zbritur në vlerë prej 4,000 euro. Gjoha tjera janë në nëntor 2021 në vlerë prej 3,000 euro⁸³, në tetor 2021 po ashtu ka një gjobë në vlerë prej 2,000 euro⁸⁴ dhe në tetor 2019 ka po ashtu një gjobë në vlerë prej 2,000 euro⁸⁵. Duhet theksuar se deri në qershor 2023 ka paguar gjithsej tri këste për tarifa në vlerë prej 1,771 euro ndërsa të tjerat janë borxhet nga gjobat.

OSH 10 - i pajisuar me licencë në vitin 2008, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 14,374 euro për gjoba të shqiptuar përgjatë vitit 2021. Me 16.03.2021 ka shqiptuar gjobë në vlerë prej 5,000 euro për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës. Me 18.10.2021 po ashtu ka shqiptuar gjobë në vlerë prej 2,000 euro ndaj ofruesit ë shërbimeve për shkele të Ligjit për Zgjedhje dhe për shkelje të kodit të etikës. Me datë 11.11.2021 ka shqiptuar gjobë në vlerë prej 4,000 euro për shkelje të rregullores për komunikime komerciale dhe shkelej të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Me datë 11.02.2021 ka shqiptuar gjobë në vlerë prej 5,000 euro për shkelje të Ligjit të KPM-së dhe për shkelje të rregullores për komunikime komerciale dhe audiovizuale. Nga borxhi total 16,000 janë paguar 1,625 euro.

OSH 23 - i pajisuar me licencë në vitin 2015, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 46,477 euro e cila është tarifë vjetore për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

OSH 24 - i pajisuar me licencë në vitin 2008, ka një detyrim/borxh ndaj KPM-së në vlerë prej 20,000 euro për mos pagesë të tarifës vjetore për vitin 2019.

⁸³ Shkeljeve të Rregullores për Komunikime Komerciale Audivizuele.


⁸⁴ Shkelje të rregullores së KPM për Komunikime komerciale dhe të kodit të Etikës.

⁸⁵ Shkelje të neni 9 paragrafi 7 të kodit të etikës dhe shkelje të rregullores për komunikime.

III. Shtojca III. Letër konfirmimi dhe komentet e entitetit



14-02-2024
Ref. 2402/267/KPM/jm
REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: KPM- 14.02.2024

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me përmbajtjen e Raportit, kurse për disa nga të gjeturat dhe rekomandimet kemi ofruar komentet tona të bashkangjitura si shtojcë; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i KPM
Jeton Mehmeti



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Kryetari i Zyrës Kombëtare të Auditimit			
DATE E KRYESORIT: 15-02-2024			
Pro. Jedn. Org. Unit	Shit. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	145	1



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: “Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur për Media”

Dokumenti: Komentet nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit

Te gjeturat	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne raste te mospajtimi	Pikëpamja e ZKA-së
3.1.1 Mos përmbushja e kriterëve me rastin e licencimit të operatorëve të shpërndarjes për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale	JO	<p>Në bazë të Rregullores KPM-2020/01 nuk kërkohet marrëveshje për kanalet të cilat e kanë statusin e bartjes se obligueshme. Ne lidhje me këtë çështje neni 10 pika 1 e kësaj rregullore përcakton se:</p> <p>"OSHMA-të të cilat nuk e gëzojnë statusin e bartjes se obligueshme, mund të barten nga operatorët e shpërndarjes vetëm në bazë të marrëveshjes valide".</p> <p>Pra bazuar në këtë nen marrëveshja kërkohet vetëm për ato subjekte që nuk e gëzojnë statusin e bartjes se obligueshme (nuk shfrytëzojnë frekuencë) dhe kanalet tjera të cilat vijnë nga jashtë Kosovës.</p> <p>Gjithashtu, sipas Rregullores KPM-2020/01, Shtojca e kësaj rregulloreje lidhur me procedurat dhe kriteret e licencimit, kontratat mbi të</p>	<p>E gjetura qëndron pasi që në nenin 3 të rregullores së KPM për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përcaktohen kriteret e licencimit, pa përjashtim apo plotësim të më vonshëm të ndonjërisë nga këto kritere, një prej tyre është dhe pika 6- Dëshmitë mbi gatishmërinë për sigurimin e marrëveshjeve valide për të drejtën e transmetimit. Bazuar në nenin 1 të shtojcës së po kësaj rregulloreje për të aplikuar për licencë në KPM, parashtruesi i</p>

		<p>drejtat e transmetimit nuk janë kriter për licencim.</p> <p>Prandaj, propozojmë që kjo e gjetur të largohet nga draft raporti.</p>	<p>kërkesës duhet të dorëzojë aplikacionin e përcaktuar nga KPM, se bashku me materialin mbështetës, ku licenca mund të lëshohet për secilin person juridik të interesuar, i cili i plotëson kushtet dhe kriteret e domosdoshme në mënyrë të qartë dhe të detajuar ashtu siç janë përcaktuar mbi bazën e ligjit dhe të akteve nënligjore.</p>
<p>3.2.2 Mungesa e respektimit të dispozitave materiale</p>	JO	<p>Mos pagesa e tarifave dhe gjobave nuk paraqet obligim ligjore që të refuzohet ripërtëritja e licencës. Kjo është një e drejtë e KPM-se mirëpo jo obligim. Pezullimi ose ndërprerja e licencës dhe mos ripërtëritja e licencës paraqet masën e fundit ligjore dhe sanksionin me të ashpër dhe si e tille duhet te vije ne shprehje vetëm ne raste te jashtëzakonshme për faktin se mund te cenohet lira e shprehjes dhe informimit. KPM si institucion i pavarur ka marr një qëndrim që të përdoren mekanizma tjerë ligjore përmes të cilave realizohen kërkesat financiare te KPM-se, duke i proceduar rastet tek përmbartuesi privat. Kjo është konsideruar si</p>	<p>Komenti nuk qëndron sepse në asnjë rast nuk kemi thënë që duhet të refuzohet ripërtëritja e licencës. Kemi thënë që pavarësisht autoritetit të dhënë me ligj, ku lejon KPM-në të lëshojë vërejtje me shkrim ose t'u shqiptojë gjobë për shkelje të kushteve të licencës, në asnjë prej këtyre rasteve nuk është ndërmarrë asnjë veprim i tillë. KPM ka shkuar direkt me procedimin e lendeve për mbledhjen e detyrimeve financiare përmes përmbartuesit</p>

	<p>një balance ne mes te drejtës për te operuar dhe inkasimit të obligimeve financiare! Edhe vet rregullorja për Tarifat përcakton se mos pagesa e tarifave MUND te shpie ne revokim por nuk thotë se duhet te revokohet licenca, pra kjo i takon KPM-se ta vlerësojë! Sa i përket pagesës së tarifës administrative për ripërtëritje të licencës në vlerë prej 100 eurove, nëse nuk është dorëzuar dëshmia ajo çdo herë është vërtetuar përmes sistemit elektronik të pagesave nga Divizioni i Financave të KPM-së (ashtu siç është vërtetuar edhe nga ana juaj) dhe pastaj është proceduar kërkesa për shqyrtim nga Komisioni.</p> <p>Pagesat e taksës administrative behën ne shumicën e rasteve online dhe palët dërgojnë dëshminë e pagesës përmes emaili, e njëjta pastaj vërtetohet edhe ne sistemin e financave dhe mandej rasti procedohet ne komision. Asnjëherë ne asnjë rast te vetëm nuk ka ndodh qe të procedohet një rast i tillë ne KPM dhe te mos ketë paguar fillimisht taksen administrative.</p> <p>KPM ka adresuar ne gjykata dhe tek përmbaruesi te gjitha rastet e mos pagesës se taksës dhe gjobave pa përjashtim.</p> <p>Propozojmë që një e gjetur e tillë të largohet nga raporti për faktin</p>	<p>privat. Shfrytëzimi i mekanizmave sikurse janë gjykatat dhe përmbaruesi nxjerr në pah paaftësinë e KPM-së për të mbledhur në mënyrë efektive tarifat e papaguara dhe për të zbatuar llogaridhënien financiare.</p> <p>Sa i përket pagesës se tarifës administrative prej 100 euro, të njëjtën situatë e kemi paraqitur ne raport, siç e keni sqaruar. Thjesht, dëshmitë nuk kane qenë në dosje dhe nuk kemi thënë qe është proceduar tutje pa këtë pagesë.</p>
--	---	---

		se nuk kemi të bëjmë me shkeljen e dispozitave material.	
3.2.3 Mungesa e konsistencës në dhënien e rekomandimeve nga KPM për ripërtëritje të licencave të mediave	JO	Nuk mendojmë se është jo konsistence në dhënien e rekomandimeve, mirëpo në rastet e ripërtëritjeve të licencave kur kandidatët kanë kryer pagesat e obligimeve financiare ndaj KPM-së, përmes rekomandimi është njoftuar Komisioni se kandidati ka kryer obligimet financiare. Ndërsa, në ato raste kur kandidati ka pasur obligime financiare, është rekomanduar ripërtëritja e licencës ngase në fuqi ka që vendim KPM V3/2016 i cili ka mundësuar ripërtëritjen e licencave edhe nëse të licencuarit kanë pasur obligime financiare dhe me të njëjtin i ka udhëzuar të licencuarit që ti shlyejnë obligimet, në të kundërtën ato do të realizohen përmes procedurave ligjore të Përmbaruesit Privat. Gjithashtu, nuk pajtohemi me konstatimin se mënyra e rekomandimeve zbehë transparencën dhe drejtësinë e procesit apo favorizime apo njëanshmëri, sepse secilit subjekt që ka dorëzuar kërkesë për ripërtëritje dhe ka plotësuar kriteret i është ripërtëritur licenca. Evidentimi në rekomandime në disa raste kur kandidatet nuk kanë pasur obligime ka qenë për ta informuar Komisionin se kandidatin i caktuar është i rregullt dhe ka shlyer obligimet	E gjetura qëndron sepse pavarësisht që vendimi ka lejuar që edhe përkundër borxheve të vazhdohet me ripërtëritje të licencave vlerësojmë se rekomandimet për ripërtëritje duhet të jenë të unifikuara. Si për OSH që kanë obligime si për ato të cilat nuk kanë obligime vlerësojmë që të cekën në rekomandime. Të paktën për auditorët është e rëndësishme por po ashtu edhe për nevojat e brendshme të KPM.

		<p>financiare dhe se përderisa licencat u janë vazhduar të gjithëve pavarësisht obligimeve financiare, mungesa e evidentimit në rekomandime se disa prej kandidatëve kanë obligime financiare nuk ka qenë përcaktuese në vendimmarrjen e Komisionit për ripërtëritje të licencës (për fatin se në fuqi ka qenë vendimi KPMV3/2016 i cili ka mundësuar ripërtëritje e licencës edhe të licencuarve që kanë obligime financiare të pa paguara).</p>	
<p>3.3 Dështimet në pezullimin dhe revokimin e licencave nga KPM dhe borxhet e akumuluar nga OSH-të</p>	JO	<p>Mos pagesa e tarifave dhe gjobave nuk paraqet obligim ligjor që të pezullohen ose ndërpriten licencat e transmetimit. Kjo është një e drejtë e KPM-së mirëpo jo obligim. Pezullimi ose ndërprerja e licencës paraqet masën e fundit ligjore dhe sanksionin më të ashpër dhe si e tillë duhet të vije në shprehje vetëm në raste të jashtëzakonshme për faktin se mund të cenohet liria e shprehjes dhe informimit. KPM si institucion i pavarur ka marr një Qëndrim që të përdoren mekanizma tjerë ligjorë përmes të cilave realizohen kërkesat financiare të KPM-së, duke i proceduar rastet në gjykatë dhe tek përmbartuesi privat. Kjo është konsideruar si një balance në mes të drejtës për të operuar dhe inkasimit të obligimeve financiare! Edhe vet rregullorja</p>	<p>E gjetura qëndron sepse KPM nuk ka shfrytëzuar mekanizmat e saj të brendshëm për ti paraprirë gjendjes së tanishme të krijuar me borxhet.</p> <p>Mungesa e monitorimit të rregullt dhe vlerësimit të gjendjes së OSH-ve ka bërë që KPM të mos arrijë të vlerësoj me kohë dhe të marr parasysh kërkesat e OSH-ve për ndërprerjen dhe pezullimin e licencës ku për pasojë janë akumuluar borxhe.</p> <p>KPM ka tentuar të shqiptoj masa</p>

		<p>për Tarifat përcakton se mos pagesa e tarifave MUND te shpie ne revokim por nuk thotë se duhet te revokohet licenca, pra kjo i takon KPM-se ta vlerësojë!</p> <p>Sa i përket rastit të OSH14 lidhur me marrëveshjen për shlyerjen e obligimeve financiar nga gjoba me këste KPM ka vlerësuar si mekanizëm shume efikas marrëveshjen me palën për ta realizuar inkasimin e gjobës, po ashtu KPM duke u bazuar në kërkesën e palës për ti mundësuar pagesën me këste për shkak të shumës së lartë të gjobës, i ka mundësuar palës pagesën me këste në mënyrë që e njëjta të mos ballafaqohet me vështirësi financiare të cilat do të rezultonin në dështimin e palës në pagesën e gjobës dhe funksionimit të licencuarit në fjalë.</p>	<p>progresive sa i përket shkeljeve të kritereve mirëpo në vitin 2021 po ashtu ka një shkelje të kriterit të njëjtë, megjithatë ka shqiptuar gjobë më të ultë se në vitet 2019 dhe 2017.</p> <p>KPM ka gjobitur televizionin disa herë për shkelje të njëjta dhe nuk ka ndërmarrë hapa të fuqishëm për të pezulluar programet e tyre ose për të revokuar licencën e tyre si mekanizëm efikas për të ndaluar shkeljet programore.</p> <p>Disa OSH të medias audio-vizuale janë përballur me pezullim ose revokim për shkak të mos veprimtarisë, të tjerë OSH nuk janë përballur, ku për pasojë, kemi borxhe të akumuluar të OSH-ve nëpër vite dhe KPM nuk ka arritur ti mbledh as përmes marrëveshjeve për pagesë të kësteve dhe as përmes përmbaruesit në mënyrë efektive.</p>
--	--	---	--

			<p>Për faktin që në vitin 2023 KPM ka marrë një vendim që mediat të cilat nuk paguajnë obligimet financiare nuk do të vazhdojnë transmetimin tregon që një e gjë e tillë ka mundur të merret edhe me parë në mënyrë që mos të lejohet grumbullimi i borxheve.</p>
<p>3.4 Dobësitë në mbledhjen e borxheve të OSH-ve nga ana e KPM-së</p>	<p>JO</p>	<p>Nuk mund të vlerësohet si dobësi në mbledhjen e borxheve për faktin se KPM ka ndërmarrë të gjitha veprimet për inkasimin e obligimeve financiare (borxheve) duke dërguar të gjitha lëndët pa përjashtim në gjykatë dhe tek përmbaruesi privat. Sidoqoftë, për shkak të procedurave të komplikuar në përmbarimin e lëndëve dhe vonesave në ekzekutimin e këtyre lëndëve si rezultat i procedurave ligjore KPM ka vendosur që të mos vazhdoj licenca nëse subjektet kanë obligime financiare sa i përket tarifës.</p> <p>Lidhur me borxhet e grumbulluara, KPM me datë 19.07.2023 ka nxjerr Vendim për të gjithë të licencuarit që kanë obligime financiare, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i kryejnë të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së ose të</p>	<p>Komenti nuk qëndron pasi që ka vonesa me muaj dhe vite ku nuk janë procesuar lëndët tek përmbaruesi nga KPM (mund ti referoheni tabelës 4 në raport).</p> <p>Sa i përket vendimit me datë 19.07.2023 – “Vendim për të gjithë të licencuarit që kanë obligime financiare, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i kryejnë të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së” është cekur në raport.</p>

		<p>bëjnë marrëveshje valide përmes së cilës dëshmohet se të gjitha obligimet do të përmbushen në afat prej 12 muajve.</p> <p>Pas këtij Vendimi, marrëveshje kanë bërë tri (3) subjekte transmetuese me KPM-në dhe dhjetë (10) subjekte transmetuese me përmbaruesin privat, të cilat janë duke i kryer pagesat me këste.</p> <p>Është me rëndësi të ceket se në tri vitet e fundit kemi një inkasim të mbi 97 % të të hyrave të planifikuara nga subjektet transmetuese.</p> <p>Ndërsa sa i përket obligimeve financiare të viteve paraprake janë si vijon:</p> <p>Nga totali i borxheve 34.90 % janë borxhe nga gjobat, e që në shumicën e rasteve të njëjtat janë kontestuar në gjykata dhe KPM ka obligim që të pres vendimet nga gjykata lidhur me këto raste.</p> <p>Vetëm transmetuesi publik (RTK) obligohet 35 % të totalit të borxheve në KPM, me ligjin e KPM-së nuk kemi të drejt të njëjtit të revokojmë licencën, e vetmja mënyrë është përmes adresimit në gjykata dhe tek përmbaruesi privat.</p> <p>Pra, këto janë masat që KPM ka ndërmarrë në adresimin e kësaj problematike.</p>	
--	--	---	--

<p>3.5 Revokimet e Licencave të ofruesve të shërbimeve mediatike nga KPM</p>	<p>JO</p>	<p>Në të gjitha rastet kur KPM ka pranuar njoftim për heqje dore nga licenca ka vepruar menjëherë, duke mos i ngarkuar me tarife vjetore në vitin pasues dhe duke marre vendim për ndërprerje të licencës.</p> <p>Me rastin e licencimit të OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve siç ka qenë edhe Alsat Kosova, me kushte e licencës apo bazës tjetër ligjore të KPM-së nuk është përcaktuar afati i fillimit të transmetimit (sikur ka qenë i përcaktuar ky afat tek Televizionet dhe radiot me transmetim taksorë të cilat kanë qenë të obliguara të fillojnë brenda 90 dite nga licencimi i tyre), deri në vitin 2021, ku me Rregulloren KPM 2021/01 është përcaktuar afati i fillimit të transmetimit tani për të gjithë Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele pavarësisht formës së transmetimit. Prandaj, pavarësisht mos fillimit të transmetimit i licencuari ka qenë i obliguar të paguaj tarifë vjetore të licencës për arsye se ai ka poseduar licencë valide nga KPM.</p> <p>Sa i përket pezullimit të licencës të kërkuar nga i licencuari, askund në legjislacionin primarë</p>	<p>Edhe kjo e gjetur qëndron pasi që janë dhënë mjaftë arsytetime në raport (madje e kemi sqaruar situatën e njëjtë siç e keni prezentuar edhe ju) e gjithashtu edhe shkakun është prezentuar.</p>

		<p>dhe sekondarë të KPM-së nuk ka qenë e paraparë pezullimi i licencës si mundësi për të licencuarin (ashtu siç ka kërkuar i licencuar që përkohësisht ti pezullohet) dhe për këtë është njoftuar pala në takime si edhe çdo i licencuar tjetër i cili ka pasur kërkesë të ngjashme se ata mund të heqin dorë nga licenca mirëpo, nuk ekziston mundësi e pezullimit të licencës për një periudhë kohore për ta aktivizuar përsëri licencën.</p> <p>Siç mund ta shihni edhe në e-mail-in e datës 25 shkurt 2012, Alsat Kosova ka kërkuar pezullim të përkohshëm të licencës e jo heqje dore nga licenca dhe ndërprerje të saj, prandaj KPM e ka ngarkuar me tarifë vjetore të licencës deri në momentin që pala ka kërkuar heqje dorë nga licenca (kërkesa e datës 16 dhjetor 2013, ku është referuar si pushim të licencës e që edhe përmes komunikimeve me palën është sqaruar se nuk duan më tutje të mbajnë licencën e KPM-së për Alsat Kosova) dhe pastaj KPM ka marr vendim për ndërprerjen e licencës.</p> <p>OSHMA Tribuna Channel ka qenë një televizion i cili viteve të fundit ishte konkurrues serioz në tregun medial me përmbajtje të rëndësishme programore, mirëpo që kohëve të fundit kishte probleme financiare dhe</p>	
--	--	--	--

		<p>ndërprerje të transmetimit. Duke marr parasysh që KPM deri më tani nuk ka ndërprerë asnjë licencë për arsye të mos pagesës së tarifës nuk e ka bërë këtë edhe në rastin e Tribuna Channel dhe gjithashtu, edhe nga ana e të licencuarit nuk ka pasur kërkesë/njoftim për heqje dorë nga licenca, madje në takimet që kemi pasur ka qenë i interesuar për vazhdimin e licencës dhe përpjekje për gjetjen e mundësive për shlyerjen e borgjeve. Me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM -2021/01 është përcaktuar afati i fillimit të transmetimit për të gjitha OSHMA me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes të cilat nuk janë duke transmetuar që të fillojnë transmetimin brenda 90 ditëve në të kundërtën do të marr vendim për ndërprerjen e licencës. Lidhur me këtë përcaktim të gjitha ata të cilat nuk kanë qenë duke transmetuar janë njoftuar në mënyrë zyrtare dhe për të gjitha OSHMA-të që nuk kanë vepruar në pajtim me rregulloren në fjalë lidhur me transmetim janë hapur raste ligjore të cilat kanë rezultuar me vendimet e Komisionit për ndërprerjen e licencës për këtë arsye, por edhe arsye tjera si rrethana të cilat janë vlerësuar rrethana rëndues.</p>	
--	--	---	--

